

Decentralization and Local Development Programme (dldp)
Mbështetja ndaj Bashkisë Malësi e Madhe për planin afatshkurtër
dhe planin e integruar të manaxhimit të mbetjeve



PLANI LOKAL

PËR MANAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË BASHKINË MALËSIA MADHE

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	8
1.1.	Koncepte mbi planin lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane.....	8
1.1.1.	Nevoja për hartimin e një plani lokal të menaxhimit të mbetjeve	8
1.2.	Hartimi i planit.....	9
2.	POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR	10
2.1.	Politika dhe Strategjia Kombëtare mbi mbetjet	10
2.2.	Principet e Menaxhimit të mbetjeve	11
2.3.	Kuadri ligjor shqiptar mbi mbetjet.....	12
2.4.	Rolet dhe përgjegjësitë.....	13
3.	PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME	13
3.1.	Profili i Bashkisë.....	13
3.1.1.	Demografia	15
3.1.2.	Burimet natyrore	16
3.1.3.	Aspekti social-ekonomik.....	17
3.1.4.	Gjendja e përgjithshme mjedisore.....	18
3.2.	Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve.....	19
3.2.1.	Organizimi në nivel qendror	19
3.2.2.	Organizimi në nivel lokal.....	20
3.2.3.	Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet	22
3.3.	Analiza e mbetjeve (prodhimi, përbërja)	23
3.4.	Infrastruktura për grumbullimin, transportin dhe depozitimin final të mbetjeve.....	26
3.5.	Shërbimet e mbetjeve.....	28
3.5.1.	Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane	28
3.5.3.	Depozitimi.....	30
3.5.4.	Riciklimi	30
3.6.	Administrimi i mbetjeve voluminoze	31
3.7.	Ekonomia dhe financimi	31
3.7.1.	Buxheti i shërbimit të pastrimit.....	31
3.7.2.	Tarifat dhe realizimi i të ardhurave.....	32
4.	Planifikimi lokal i menaxhimit të Mbetjeve	34
4.1.	Vizioni.....	34

4.2.	Objektivat.....	34
4.3.	Objekti i Planit	35
4.3.1	Rryma e mbetjeve, objekti i planit	35
4.3.3	Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit.....	36
4.4.	Evidentimi i alternativave për administrimin e mbetjeve	37
4.4.1.	Shërbimet e pastrimit të rrugëve	37
4.4.2.	Mbledhja e mbetjeve.....	38
4.4.3.	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve.....	54
4.4.4.	Proceset e Minimizimit të Mbetjeve	57
4.4.5.	Manaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore	61
4.4.6	Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve	62
4.4.8.	Mbetjet jo-urbane.....	72
4.5.	Treguesit e performancës.....	74
4.6	Skenarët e administrimit të mbetjeve.....	75
5.	PERSPEKTIVA FINANCIARE.....	78
5.1.	Financimi dhe strategjia e “mbulimit të kostos.....	78
5.1.2.	Strategjia e mbulimit të kostos dhe niveli i tarifave.....	83
6.	KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....	90
6.1.	Rregullorja vendore.....	90
6.2	Zbatimi dhe sanksionet	90
6.3	Licencimi mjedisor	91
6.4	Pjesëmarrja e sektorit privat.....	91
6.5	Mbështetja politike.....	92
7.	NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK.....	93
8.	Plan Veprimi	95
8.1.	Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional	95
8.2.	Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve	97
8.3.	Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve.....	97
8.4.	Komponenti: Ndarja dhe Riciklimi i mbetjeve	98
8.5.	Komponenti: Aspektet Financiare	100
8.6	Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi	101
9.	RISHIKIMI I PLANIT	103

9.1. Monitorimi	103
10. IMPAKTI I PROCESIT TË PLANIFIKIMIT	105
ANEKS I: PLAN I DETAJUAR PËR PROGRAMIN E NDËRGJEGJËSIMIT NË LIDHJE ME PROCESIN E MANAXHIMIT TË MBETJEVE DHE SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË TYRE	107
Objektivat e projektit dhe të programit të ndërgjegjësimit	107
Programi i fushatës ndërgjegjësuere dhe informuese për manaxhimin e mbetjeve	108
Informimi për Sistemin e ri të tarifave	111
Kompostimi i mbetjeve	112

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Hierarkia e Mbetjeve	11
Figura 2 Harta e pozitës gjeografike të Bashkisë Malësi e Madhe sipas ndarjes së re administrative	14
Figura 3 Harta e zonave të mbrojtura në territorin e Bashkisë Malësia Madhe	16
Figura 4 Pamje nga Liqeni i Shkodrës	17
Figura 5 Pamje nga Liqeni i Shkodrës	18
Figura 6 Struktura e Bashkisë Malësia Madhe për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve	22
Figura 7 Shpërndarja aktuale e kontenierëve në NJA Koplík	26
Figura 8 Grumbullimit të mbetjeve në NJA Gruemirë përpara vendosjes së kontenierëve	27
Figura 9 Pikat e grumbullimit të mbetjeve në NJA Qendër	28
Figura 10 Venddepozitimi i mbetjeve në NJA Koplík	30
Figura 11 Niveli i tarifave të pastrimit në Bashkinë Malësia Madhe	33
Figura 12 Realizimi i të ardhurave	34
Figura 13 Lëvizja e makinës 10 në turni 2 – Varianti 2	49
Figura 14 Lëvizja e makinës 10 në turni 1 – Varianti 2	50
Figura 15 Lëvizja e makinës 7 ton në NJA Kelmend – Varianti 2	51
Figura 16 Lëvizja e makinës 7 ton në NJA Qender – Varianti 2	53
Figura 17 Sistemi për ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme	55
Figura 18 Hierarkia e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme	57
Figura 19 Roli i sektorit publik në sektorin e manaxhimit të mbetjeve	58
Figura 20 Mënyrat e përfshirjes së sektorit privat në sektorin e manaxhimit të mbetjeve	59
Figura 21 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur (majtas) dhe skemat individuale në shtëpi (djathtas)	61

Figura 22 Pamje nga hedhja e mbetjeve inerte në Bashkinë Malësia Madhe	62
Figura 23 Sasia e mbetjeve që parashikohet të riciklohet gjatë 5 viteve të ardhshme	67
Figura 24 Krahasimi i kostove të skenarëve	71
Figura 25 Krahasimi i kostove njësi të skenarëve.....	72
Tabela 26 Performanca e Bashkisë	74
Figura 27 “Skema e manaxhimit të mbetjeve – Skenari 1”	75
Figura 28 “Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 2”	77
Figura 29 Krahasimi kostove dhe investimeve sipas dy skenarëve	81
Figura 30 Tarifat sipas skenareve Zona 1	87
Figura 31 Tarifat sipas skenareve Zona 2	87

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Kudri ligjor Shqiptar	12
Tabela 2 Fshatrat në Bashkinë Malësia Madhe.....	15
Tabela 3 Statistika në Bashkinë Malësia Madhe	15
Tabela 4 Gjenerimi i mbetjeve.....	24
Tabela 5 Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.....	24
Tabela 6 Përbërja mercollogjike e mbetjeve në Bashkinë Malësia Madhe.....	25
Tabela 7 Projektioni i gjenerimit të mbetjeve	26
Tabela 8 Buxheti total i bashkisë kundrejt buxhetit të shërbimit të mbetjeve	31
Tabela 9 Alokimi i kostove sipas kontratës së pastrimit.....	32
Tabela 10 Niveli i tarifave të pastrimit për NJA të Bashkisë Malësia Madhe	33
Tabela 11 Realizimi i të ardhurave në Bashkinë Malësia Madhe gjatë vitit 2015.....	33
Tabela 12 Llogaritja e nevojës për kontenier për Skenarin I	40
Tabela 13 Kalendari i mundshëm i lëvizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve – Skenari 1.....	40
Tabela 14 Kosto e plotë – Skenari 1	44
Tabela 15 Norma e gjenerimit për dy zonat e ofrimit të shërbimit.....	44
Tabela 16 Nevoja për kontenierë sipas Variatit II	45
Tabela 17 Kalendari i mundshëm i lëvizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve – Varianti II.....	45
Tabela 18 Kosto e plotë – Skenari 2	48

Tabela 19 Llogaritjet e mundshme për stacionin e transferimit.....	64
Tabela 20 Kostot e operimit të stacionit të transferimit.....	65
Tabela 21 Projektioni i rritjes së popullsisë dhe rrymave të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme	66
Tabela 22 Projektioni i rritjes së popullsisë dhe rrymave të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme duke aplikuar riciklimin.....	66
Tabela 23 Kosto për minimizimin e mbetjeve për të dy zonat (sipas Skenarit 2).....	68
Tabela 24 Kosto me stacion transferimi dhe depozitim ne landfillin e Bushatit për të dy zonat (Skenari 3)	69
Tabela 25 Kosto me minimizim mbetjesh dhe transport ne landfillin e Bushatit – Skenari 4.....	69
Tabela 26 Kosto me minimizim mbetjesh dhe depozitim ne venddepozitim aktual – Skenari 5	70
Tabela 27 Performanca e Bashkisë	74
Tabela 28 Investimet kapitale për skenarin 3.....	79
Tabela 29 Investimet kapitale për skenarin 5.....	80
Tabela 30 Kostot administrative për Skenarin 3	82
Tabela 31 Kostot administrative për Skenarin 5	83
Tabela 32 Të dhënat mbi shkallën e gjenerimit të mbetjeve sipas konsumatorëve	84
Tabela 33 Tarifa e pastrimit për zonën 1 (Koplik, Gruemirë, Kastrat).....	85
Tabela 34 Tarifa e pastrimit për zonën 2 (Qendër, Kelmend, Shkrel).....	86
Tabela 35 Tarifa e pastrimit për zonën 1 dhe 2 kur kemi një ndërmarrje publike	86
Tabela 36 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta	92

1. HYRJJE

1.1. Koncepte mbi planin lokal të manaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane

Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMMNB) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Malësia Madhe

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMMNU është parashtrimi i një përfaqëse të qartë të politikave të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve për një manaxhim të qendrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin final të mbetjeve.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Opsionet e manaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e manaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e manaxhimit të mbetjeve;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.


1.1.1. Nevoja për hartimin e një plani lokal të manaxhimit të mbetjeve

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë**

22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

1.2. Hartimi i planit

Në kuadër të projektit “Mbështetja ndaj Bashkisë Malësi e Madhe për planin afatshkurtër dhe planin e integruar të menaxhimit të mbetjeve”, pjesë e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (DLDP), Bashkia Malësia Madhe me mbështetjen e Helvetas Sëiss Intercooperation dhe asistencën teknike të Metropoli/Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, mundësoi hartimin e Planit Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Malësia Madhe.



Në fazën e parë të projektit u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të bashkisë, përfaqësues të Co-PLAN dhe DLDP. Ata ishin pjesë e zhvillimit të Planit Lokal të Mbetjeve që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë interesave të Bashkisë. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e bashkisë, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës.

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Bashkisë së Malësia Madhe kanë asistuar gjatë gjithë kohës gjatë lëvizjeve në terren dhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë së madhe.

2. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR

2.1. Politika dhe Strategjia Kombëtare mbi mbetjet

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve¹ ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për manaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2025, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;

Edukimi: Partnerët/bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;

Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbetjeve dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave, duke marrë në konsideratë periudhat e para dhe pas pranimit. Në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbetjeve, është llogaritur që një kosto investimesh prej 150-200 Milion EURO do të kërkohej në nivel vendi dhe më pas një fond shtesë prej 52 Milion EURO në vit si kosto operacionale.

Në mënyrë që të mirëmanaxhohen mbetjet, vendi është ndarë në nivel strategjik në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë sipas qarqeve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë, por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës. Në vazhdim, çështjet e këtyre zonave të mbetjeve do të manaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbetjeve që përbëhet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë. Plani Kombëtar i Mbetjeve ka përmbledhur dhe sugjeruar disa masa dhe veprime për mirëmanaxhimin e mbetjeve urbane dhe jo urbane, nga teknologjitë e trajtimit të mbetjeve deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

¹ Miratuar në Janar 2011

2.2. Principet e Manaxhimit të mbetjeve

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- **Hierarkia e mbetjeve:** Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.




Figura 1 Hierarkia e Mbetjeve

- **Parimi reduktues:** Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;
- **Parimi parandalues:** Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet;
- **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të manaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:** Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e manaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu koston

mjedisore dhe kostoja e manaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifatat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

2.3. Kuadri ligjor shqiptar mbi mbetjet

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislativës Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislativës. Gjatë periudhës 2008-2016, legjislativi Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Manaxhimit të mbetjeve:

Tabela 1 Kudri ligjor Shqiptar

Kuadri Ligjor për Manaxhimin e Mbetjeve

Ligjet	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme"
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
VKM-të	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane"
	VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura "
	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "
	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
	VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
	VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
	VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
	VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
	VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.117, datë 13/02/21013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
	VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
	VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
	VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
	VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit

	kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
Udhëzime	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

2.4. Rolet dhe përgjegjësitë

Politika kombëtare për mbetjet ka përcaktuar me detaje ngritjen dhe miratimin e disa strukturave shtesë për të mundësuar zbatimin e plotë të politikës kombëtare të mbetjeve dhe të strategjisë nëpërmjet PKMM dhe të një serie të planeve të "Zonave të Mbetjeve" si dhe planeve lokale. Strukturat e reja të propozuara janë:

- i. **Komiteti Ndërmintor për Mbetjet (KNMM):** Ky komitet është një organ themelor në nivel qendror; ai do të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë në nivel zv/ministrash nga secila ministri që lidhet drejtpërsëdrejti me sektorin e mjedisit;
- ii. **Grupi Kombëtar Këshillues për Mbetjet (GKKM):** do të jetë një entitet politik i përbërë nga përfaqësues në nivel kombëtar dhe rajonal me kompetencë teknike në manaxhimin e mbetjeve. Përfaqësuesit mund të zgjidhen nga sektori publik dhe privat me qëllim këshillimin e ministrave në aspekte të ndryshme të strategjisë së planifikimit të manaxhimit të mbetjeve, politikës dhe investimeve;
- iii. **Grupet e Zonave të Mbetjeve (GZM):** të përbërë nga përfaqësues në nivelin rajonal dhe lokal që do të sigurojnë zhvillimin e planeve, politikave dhe projekteve në partneritet dhe interes lokal për zbatimin e strategjisë dhe politikës kombëtare të mbetjeve. Ky grupim do të ketë përgjegjësi rajonale për këshillimin e autoriteteve rajonale dhe lokale në çështje të manaxhimit të mbetjeve dhe do të jetë përgjegjës për të siguruar, që planet rajonale dhe lokale të ofrojnë qëndrueshmëri dhe të jenë efektive, eficiente dhe të mirëkoordinuara midis tyre dhe në përputhje me politikën kombëtare. Grupi i Zonave të Mbetjeve do të kryesohet nga një përfaqësues i Këshillit të Qarkut dhe mbështetja për sekretarinë, anën administrative dhe aktivitetet e tij për grupin e zonave të mbetjeve do të sigurohet nga Qarku. Anëtarët e Grupit të Zonave të Mbetjeve do të jenë ekspertë rajonalë për manaxhimin e mbetjeve, por do të ketë gjithashtu edhe përfaqësues nga sfera të tjera të interesit si autoritetet lokale dhe rajonale, kompanitë e mbetjeve apo industria e riciklimit, ekspertët lokalë të pavarur apo OJQ-të me eksperiencë për çështjet e mbetjeve.

3. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1. Profili i Bashkisë

Bashkia Malësia Madhe është një njësi administrative me shtrirje të gjerë territoriale në pjesën veri-perëndimore të territorit të Republikës së Shqipërisë, ku kufizohet me Malin e Zi në pjesën perëndimore dhe veriore dhe me Bashkinë Shkodër në pjesën Jugore dhe lindore. Gjithashtu një pjesë e mirë e territorit të Bashkisë në pjesën perëndimore laget nga Liqeni i Shkodrës. Duke pasur këtë shtrirje kjo bashki ka një

territor mjaft tërheqes me karakteristika gjeografike të jashtzakonshme (Alpet e Shqipërisë, Liqeni i Shkodrës), por edhe zonat e mbrojtura në Kelmend si Thethi, apo zonat e mbrojtura pranë liqenit të Shkodrës. Nga ky këndvështrim kjo bashki ka potencial të mirë për tu zhvilluar në fusha të ndryshme si hoteleri-turizem, sporte dimërore, etj.




Figura 2 Harta e pozitës gjeografike të Bashkisë Malësi e Madhe sipas ndarjes së re administrative. Në kuadër të reformës së re territoriale, Bashkia Malësi e Madhe aktualisht përbëhet nga 6 NJA (Njësi Administrative), të cilat janë: Koplík, Gruemirë, Qendër, Kastriot, Shkrel, Kelmend, ku qendra e bashkisë është qyteti i Koplikut. Bashkia ka një sipërfaqe prej 950km², gjithashtu nën administrimin e bashkisë është edhe gjatësia prej 2.7 km e bregut të Liqenit të Shkodrës.

Bashkia e madhe ka një popullsi afërsisht 58,964 banorë (sipas të dhënave të gjendjes civile) dhe 38,358 banorë (sipas vlerës të grantit të llogaritur nga Ministria e Financës). Në total në të gjithë territorin e Bashkisë numërohen 1 qytet dhe 61 fshatra. Në tabelën më poshtë jepen të dhëna më të detajuara.

Bashkia e Malësisë së madhe		
NJA	popullsia	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Koplik	5,838	Qyteti Koplik
Gruemire	11,346	"Fshatrat: Gruemirë, Borç i vogël, Grudë-Fushë, Grilë, Kurtë, Linaj-egç-Iepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Borç i Madh, Kerraj"
Qender	5,187	"Fshatrat: Bogiç-Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrun, Koplik I sipërm, Stërbeq, Lohe e Poshtme"
Shkrel	4,345	"Fshatrat: Dedaj, Bogë, Bzhetë, Bzhetë-Markaj, Lohe e sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj"
Kastrat	8,442	"Qyteti Bajzë, Fshatrat: Ivanaj, Aliaj, Gradec, Hot, Jeran, Pjetrosan, Rapshë, Vukpalaj, Premal, Goraj-Budishtë, Kastrat, Bratosh"
Kelmend	4,108	"Fshatrat: Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç"

Tabela 2 Fshatrat në Bashkinë Malësia Madhe

3.1.1. Demografia

Bazuar në të dhënat e Bashkisë, Malësia e Madhe është një ndër qendrat e veriut, e cila ka pësuar një rritje të konsiderueshme të popullsisë gjatë këtyre dy dekadave të fundit (raporti lindje/vdekshmeri).

Por gjithësisht ka një tendencë të migrimit të brendshëm, pra largimit nga fshatrat e thella dhe afrimit drejt qendrave si Koplik, Shkodër etj. Përgjatë vitit të fundit 2015 edhe kjo zonë ndonëse nuk ka të dhëna të sakta mendohet të jetë prekur nga emigracioni jashtë Shqipërisë dhe e reflektuar edhe në numrin e popullsisë të deklaruar nga Ministria e Financave.

NJA	Nr. popullsisë sipas gjendjes civile 2011	Nr. popullsisë sipas MF	Nr. Familjeve	Nr. BV	Nr. BM	Nr. Inst
Koplik	10,746	5,898	3,400	299	19	17
Kastrat	12,080	8,538	3,400	74	11	22
Qender	6,229	5,199	1,565	18	2	9
Kelmend	6,562	4,074	918	10	3	14
Gruemirë	17,076	10,337	3,600	64	10	32
Shkrel	6,271	4,312	1,250	9	2	14

Tabela 3 Statistika në Bashkinë Malësia Madhe

3.1.2. Burimet natyrore

Liçeni i Shkodrës dhe bregu i tij

Një pjesë e rëndësishme e bukurive natyrore të zonës është edhe liçeni i Shkodrës, i cili përfaqëson një ekosistem kompleks dinamik, ku ndërthuren komunitete kafshësh dhe bimësh të ndryshme. Flora e kësaj zonë karakterizohet kryesisht nga drurë dhe shkurre pyjore si: shelgu, frashri i ujit, mrina, plepi i egër etj; dhe nga bimë barishtore si: graminoret, festuka, zhabina e arave, zambaku i ujit, kallami ujit, zunga, manaferrat, hithrat, lëkulprat etj. E gjithë kjo florë e pasur e bregut të liçenit shërben si ushqim për faunën e egër që popullon këtë zonë (dhelprën, lepurin, ketrin, zardafin në raste të radha edhe lundëzën etj), e cila nga viti në vit ka ardhur duke u pakësuar si pasojë e një sërë faktorëve: (i) punimi i livadheve deri në afërsi të zonës së bregut, duke i mbjellë me kultura bujqësore; (ii) fenomeni i erozionit dhe mbartja e aluvioneve, të cilat kanë shkaktuar mbylljen e kolektorëve kullues, duke i lënë të mbuluar me ujë këto livadhe në periudhën më të madhe të vitit.

Për zonën liçeni është pjesa më e rëndësishme e burimeve natyrore, ku një vend të rëndësishëm zë edhe larmia e llojeve të peshkut, të cilat historikisht kanë ndihmuar në përmirësimin e ekonomisë të banorëve të komunitetit. Në ujrat e këtij liçeni kryesisht rriten dhe zhvillohen lloje të ndryshme peshqish si: krapa, karasi, gjuhca, ngjala, ballgjeri, qefulli, macka, mëlyshi, nilbardha, sharmaku, trofta, dhe në raste të rralla kalesh. Por në vitet e fundit sasia e peshkut në këto ujra është pakësuar si pasojë e një sërë faktorësh si: (i) ndotja e liçenit nga depozitimet e mbetjeve të ndryshme; (ii) gjuetia e peshkut në periudhat që ai shumohet (prill-maj) dhe njëkohësisht përdorimi i mjeteve të ndaluara për peshkim; (iii) Gjuetia e pakontrolluar e peshkut në kohën e shumimit (në periudhën prill-maj); (iv) pakësimi i bimësisë në bregun e liçenit dhe njëkohësisht ndarja e kënetave nga liçeni në periudhën e shumimit të peshkut nga mbushja e vijave të prurjes.

Harta e zonave të mbrojtura në Malësinë e Madhe




Figura 3 Harta e zonave të mbrojtura në territorin e Bashkisë Malësi Madhe

Me një vendim të këshillit të ministrave (VKM nr. 684, datë 2.11.2005), zona shqiptare e Liqenit të Shkodrës u shpall “Rezervat natyror i manaxhuar” (kategoria e IV). Duke qënë se NJA Koplík shtrihet në pjesën lindore të liqenit të Shkodrës, dhe duke u bazuar edhe në përkufizimin e këtij vendimi, kjo zonë ka marrë statusin e zonës me zhvillim tradicional. Po kështu edhe në NJA Kelmend kemi zonën e Theth-it e shpallur si zone e mbrojtur e kategorisë II me VKM nr. 96 datë 21.11.1966.



Figura 4 Pamje nga Liqeni i Shkodrës

3.1.3. Aspekti social-ekonomik

Rajoni veri-perëndimor ndonëse ka një potencial të lartë për zhvillimin ekonomik, Qarku i Shkodrës në përgjithësi dhe zona Malësia Madhe, njihet si një ndër zonat më pak të zhvilluara të vendit.

Ndër problemet kryesore ekonomike me të cilat përballet sot qyteti mund të përmendim papunësinë, niveli i ulët i prodhimit bujqësor dhe probleme të ndryshme sociale. Ndër sektorët kryesorë të ekonomisë mund të përmendim bujqësinë, blegtorinë, sektorin e ndërtimit dhe përpunimit (agro), të cilat aktualisht konkurojnë në nivele të ulta dhe zhvillimi i biznesit familjar, shërbime, apo konfeksione të ndryshme. Në territorin e bashkisë ushtrojnë veprimtarinë rreth 474 biznese të vogla, 47 biznese të mëdha. Po kështu në këtë bashki janë dhe 108 institucione shtetërore të funksioneve të ndryshme të sektorit administrativ dhe të shërbimeve.

Bujqësia: Malësia Madhe në pjesën perëndimore të saj karakterizohet nga toka kryesisht të lehta dhe pjellore. Falë klimës mesdhetare mundësohet rritja dhe zhvillimi i shumë kulturave bujqësore si: drithëra, patate, perime, foragjerë etj. Zona e Koplíkut njihet për traditën e kultivimit të duhanit, bimëve mjeksore dhe vreshtari, duke u renditur i pari në shkallë vendi. Në pjesën lindore karakterizohet nga një reliev kodrinor-malor jo shumë i përshatshëm për bujqësinë, por këto zona shquhen për blektorinë dhe prodhime të tjera karakteristike.

Megjithë potencialin e lartë të zhvillimit të këtij sektori, ai ka hasur probleme të shumta. Pjesa më e madhe e tokës është lënë djerrë si pasojë e një sërë faktorëve: (i) mos sigurimi i shitjes së produkteve bujqësore; (ii) kosto e lartë e prodhimit të tyre dhe cilësia jo e duhur; (iii) mungesa e politikave të shtetit për mbrojtjen e prodhimeve të fshatarëve. Një problem tjetër konsiston në humbjen dhe transformimin e pakontrolluar të tokave bujqësore gjatë këtyre dy dekadave të fundit, duke bërë që pjesa më e madhe e parcelave që më parë përdoreshin për kultivimin e duhanit përgjatë zonës urbane të kthehen në zona banimi me shtëpi individuale. Kjo rënie e prodhimit bujqësor ka ndikura edhe në rritjen e nivelit të papunësisë të banorëve të zonës duke pakësuar të ardhurat familjare.

Blegtoria: Blegtoria është një tjetër degë e rëndësishme e ekonomisë të zonës. Rreth 300 ha tokë përdoren për kultivimin e foragjerëve. Kryesisht nga kjo degë e ekonomisë mund të sigurohen produkte të shumta si mishi, qumështi, leshi e lëkura etj, të cilat sjellin të ardhura ekonomike të mira për familjet që merren me këtë aktivitet. Por edhe kjo degë e ekonomisë si bujqësia ka pësuar një rënie të konsiderueshme. Numri i krerëve ka pësuar ulje drastike si pasojë e një sërë faktorëve: (i) një rënie interesi në zhvillimin e këtij sektori ekonomie; (ii) mungesa e investimeve dhe e kujdesit nga institucionet përkatëse për përmirësimin racor të krerëve.

3.1.4. Gjëndja e përgjithshme mjedisore

Në territorin e Bashkisë paraqitet një gjendje problematike mjedisore për arsye të ndryshme:

Në zonën e bregut të liqenit janë ndërtuar restorante dhe bare të ndryshme të cilat jo vetëm sjellin ndotje të ujrave të liqenit, pasi çdo gjë shkarkohet në liqen, por edhe betonizimi i bregut ka sjellë edhe prishjen e bimësisë dhe pakësimin e faunës së zonës.



Figura 5 Pamje nga Liqeni i Shkodrës

Mungesa e kanalizimeve të ujrave të qytetit, ku pjesa më e madhe e shtëpive funksionojnë me gropa septike dhe mungesa e një impianti për trajtimin e ujrave të zeza sjell probleme të shumta në rritjen e nivelit të ndotjes të ujrave të liqenit, ndotjen e peisazhit natyror dhe në uljen e numrit të pushuesve;

Një problem tjetër për mjedisin e kësaj bashkie lidhet me mbetjet dhe kryesisht ato të depozituara në shtratet e lumenjve apo tokave bujqësorë.

Aktualisht bashkia i depoziton mbetjet urbane në një fushë të hapur, e cila nuk ka asnjë status (është pronë shtetërore) dhe mbetjet vetëm sa depozitohen dhe nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi tjetër, si mbulimi me dhe' etj. Kjo fushë depozitimi ndodhet në territorin e mbrojtur duke paraqitur një problem për burimet natyrore.

3.2. Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve

3.2.1. Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Mjedisit, Ministria Transportit dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, **MM** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Shtetëror I Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

ISHMP (në zbatim të Ligjit nr. 10431) është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët që gjenerojnë mbetje. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë. **ISHMP** bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. ARM, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor **ISHSH**, **IKMT**-ja, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit (në zbatim të Ligjit nr. 10431) janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me **AKM**-më si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjencive mjedisore. Ato kanë për detyrë: (i) të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal; (ii) të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal; (iii) kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

MTI dhe më konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. **MTI** është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe propozja etj. Gjithashtu, **MTI** është autoriteti kontraktues për koncesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe menaxhimin i mbetjeve.

Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me **MM** dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit

të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007);

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të manaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Manaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (në bashkëpunim me MMPAU) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale
- Mbetjet minerale
- Rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

Ministria e Financës (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

3.2.2. Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për manaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë manaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;

- iv. Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

- (i) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- (ii) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- (iii) Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualet lokale;
- (iv) Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- (v) Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e manaxhimit të mbetjeve;
- (vi) Të bashkëpunojë me ISHMP, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
- (vii) Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Ndarja e re administrative-territoriale ka sjellë një përqëndrim të financave dhe burimeve njerëzore edhe në Bashkinë Malësi Madhe; konkretisht çdo lloj shërbimi që bashkia do të ofrojë ndaj territorit që administron dhe komunitetit banues aty do të planifikohen dhe financohen nga kjo bashki. Digrama më poshtë ilustron strukturën e bashkisë në lidhje me manaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga përfaqësuesit në nivel Këshilli Bashkiak, Kryetar Bashkie, dhe drejtuesit e shërbimeve.




Figura 6 Struktura e Bashkisë Malësi Madhe për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligji 9537).

Policia e bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve.

3.2.3. Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet

Ligji bashkitë të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal për mbetjet. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e manaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- Rregulloren bashkiake për manaxhimin e mbetjeve: është përgjegjësi e Bashkisë Malësi Madhe të hartojë këtë rregullore (duke implementuar specifikat e ndarjes së re territoriale-administrative) e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe manaxhimit të mbetjeve brenda territorit administrativ të bashkisë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak.

- Rregulloren për tarifat e mbetjeve: kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve. Rregullorja e tarifave të mbetjeve përfaqëson një politikë bashkiake afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin.

3.3. Analiza e mbetjeve (prodhimi, përbërja)

Një nga pengesat kryesore për zhvillimin e çdo plani manaxhimi mbetjesh në Shqipëri është mungesa e të dhënave të besueshme statistikore për popullsinë dhe prodhimin e mbetjeve. Me qëllim parashikimin e administrimit të mbetjeve në të ardhmen në Bashkinë e Malësisë Madhe, ishte e rëndësishme llogaritja e prodhimit aktual të mbetjeve si dhe parashikimi për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për hartimin e këtij plani dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit. Gjatë periudhës Gusht 2015-Prill 2016 u grumbulluan të dhënat të nevojshme dhe është bërë verifikimi i tyre në terren, ku janë krahasuar me të dhëna të tjera të burimeve si INSTAT, apo gjendja civile. Në bazë të këtyre të dhënave, duke iu referuar dhe studimeve të mëparshme për këtë zonë janë gjeneruar rezultate të besueshme për të ndërtuar strategjitë e ardhshme për manaxhimin e mbetjeve në këtë bashki.

Prodhimi i mbetjeve në nivel rajonal: Sipas drafteve përfundimtare të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve, Bashkia Malësisë Madhe është pjesë e Zonës së Mbetjeve të Qarkut Shkodër, në të cilën përfshihen qytetet e Shkodrës, Koplikut, Vau i Dejës, Pukës, Fushë-Arrëzit si dhe të gjitha ish-komunat e qarkut Shkodër, me një popullsi prej 252,656, që gjeneron një sasi mbetjesh prej afro 50-60 mijë ton në vit.

Prodhimi i mbetjeve në nivel vendor: Të dhënat zyrtare nga Bashkia Malësisë Madhe në lidhje me prodhimin e mbetjeve janë ende të debatueshme dhe bazohen vetëm në vlerësime të përgjithshme duke u bazuar në numrin e popullsisë të qytetit (i cili gjithashtu është i ndryshëm nese bazohet në dy burime Instat apo Ministria e Financave), kapacitetet e kontenerëve që makina teknologjike mbledh gjatë ditës, dhe sasisë së mbetjeve të riciklueshme që mund të grumbullohet nga popullsia rome. Makina që transporton mbetjet për në vend depozitim nuk peshohet dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për të numëruar ngarkesat e makinave dhe për të llogaritur vëllimin e mbetjeve në vend depozitim. Ky venddepozitim është në një fushë të hapur (tokë shtetërore) në pronësi të bashkisë dhe nuk ka as rrethim as dhe personel që të punojë aty.

NJA	Nr. Popullsisë	Norma gjenerimit	Nr. BV	Nr. BM	Nr. Insti	Norma gjenerimit BV	Norma gjenerimit BM	Norma gjenerimit Insti	Sasia ditore mbetjeve	Sasia vjetore mbetjeve
	nr.	kg/ banorë/ditë	nr.	nr.	nr.	kg/njësi/ditë	kg/njësi/ditë	kg/njësi/ditë	kg/mbetje/ditë	kg/mbetje/vit
Koplik	5,898	1	299	19	17	6	15	6	6	2,303
Grumeirë	10,337	0	64	10	32	6	15	6	4	1,586
Qender	5,199	0	18	2	9	6	15	6	2	734
Shkrel	4,312	0	9	2	14	6	15	6	2	612
Kastrat	8,538	0	74	11	22	6	15	6	4	1,517
Kelmend	4,074	0	10	3	14	6	15	6	2	589
Total	38,358		474	47	108				20	7,341

Tabela 4 Gjenerimi i mbetjeve

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin e ri të Bashkisë Malësia Madhe ofrohet vetëm në 5 NJA (Koplik, Shkrel, Kastrat, Kelmend, Gruemirë) nga 6 që janë gjithsej (në Qendër shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nuk ofrohet). NJA Koplik deklaron që ofron shërbimin për 98% të popullsisë, NJA Shkrel për 58% të popullsisë, NJA Kastrat për 80%, dhe NJA Kelmend për 24%, NJA Gruemirë 80%. Të gjitha NJA që ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Malësia Madhe, e ofrojnë vetë këtë shërbim me ndërmarrjet e tyre. Kopliku e ofron shërbimin me një turn 6 herë në javë, Shkreli e ofron me 1 turn 3 herë në javë, Kastrati e ofron me një turn 4 herë në javë dhe Kelmendi e ofron me një turn 1 herë në javë ndërsa Gruemira (e cila këtë shërbim e ka filluar në muajin Prill 2016 dhe përdor makinën e Koplikut) këtë shërbim e kryen 2 herë në javë.

Bashkia (njesite perberese)	% e popullsisë që merr shërbim
Koplik	98%
Gruemirë	80%
Qendër	0%
Shkrel	58%
Kastrat	80%
Kelmend	24%




Tabela 5 Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe

Përbërja e mbetjeve në Bashkinë Malësia Madhe: Përbërja e mbetjeve të një prodhuesi ose grupi prodhuesish është një e dhënë mjaft e rëndësishme për zhvillime të mëtejshme në fushën e manaxhimit të mbetjeve për përcaktuar politikat e duhura lidhur me riciklimin apo ripërdorimin e mbetjeve, trajtimin final të tyre apo hapa të tjerë në funksion të zhvillimeve. Aktualisht nuk ka asnjë matje të rrymave të mbetjeve që gjenerohen në territorin kësaj Bashkie. Studime të mëparshme të kryera në zona me tipologji të njëjtë² si ajo e Malësisë së Madhe mund të na japin një pamje të përafërt të gjenerimit të këtyre rrymave në Bashkinë Malësia Madhe. Për këtë mund të marrim rrymat e mbetjeve të matura në dy qendrave si Vora dhe Fushë-Kruja dhe të mesatarizojmë rezultatin e matur në këto dy njësi.

² Në funksion të hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve

Kategoritë e mbetjeve	Vorë %	F.Krujë %	MM* %
Organike	51.7%	52.3%	52%
Letër+Karton	9.9%	10.1%	10%
Plastike	10.6%	11.5%	11%
Qelq	4.7%	5.0%	5%
Tekstil	5.4%	4.6%	5%
Hekur	1.2%	1.6%	1%
Inerte	6.2%	7.2%	7%
Sanitare	3.3%	2.5%	3%
Të tjera	7%	5.0%	6%
Total	100%	100%	100%




Tabela 6 Përbërja mercollogjike e mbetjeve në Bashkinë Malësia Madhe

Sasia e biodegradueshme organike është në përqindje më të lartë duke çuar drejt mundësisë së prezantimit të skemave të kompostimit të mbetjeve, kryesisht në zonat me shtëpi private. Për sa i takon mbetjeve të riciklueshme, letra+karton, plastika, qelqi pëfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme duke krijuar mundësinë e prezantimit dhe konsolidimit të industrisë së riciklimit në rajon.

Rezultatet tregojnë që gjenerohet një përqindje e konsiderueshme e mbetjeve inerte. Gjithsesi lind nevoja që periodikisht (1 herë në 5 vjet) këto matje të ribëhen për të pasur një pasqyrim më të qartë dhe të përditësuar të gjenerimit në përqindje të rrymave të mbetjeve, veçanërisht për të konstatuar mbetjet e rrezikshme, si mbetjet spitalore apo industriale që hyjnë në rrjedhën e mbetjeve vendore, me qëllim trajtimin e çështjes nga autoritetet, mbetjet inerte e kështu me radhë.

Parashikimi i prodhimit të mbetjeve në të ardhmen lidhet ngushtë me rritjen e numrit të popullsisë në të shkuarën (norma vjetore e rritjes në të shkuarën e llogaritur duke iu referuar tendencës së rritjes së popullsisë gjatë periudhës 2011-2015 – 0.34%³) si dhe prirjet për prodhimin e mbetjeve në të ardhmen. Praktikisht, siç u përmend edhe më parë, bashkia nuk ka të dhëna të besueshme për prodhimin e mbetjeve për 5 vitet e fundit për shkak të mungesës të matjeve të sakta të mbetjeve të depozituara. Për këtë qëllim, të gjitha të dhënat e marra nga regjistri i sektorit të shërbimit janë përshtatur duke marrë parasysh sasinë e supozuar për vitin 2015 dhe që lidhet me vlerësimin e koeficientit të prodhimit të mbetjeve si dhe prirjen e tij për 5 vitet e fundit. Viti 2015 do të merret edhe si referencë për të parashikuar sasinë dhe karakteristikat e mbetjeve në të ardhmen (periudhen 2015-2020).

Në tabelën e mëposhtme jepet parashikimi i prodhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe për 5 vitet në vazhdim:

³ Të dhëna të Qarkut Shkodër 0.34%

Viti		2015	2016	2017	2018	2019	2020
Projeksioni i rritjes së popullsisë	nr.	38,358	38,488	38,619	38,751	38,882	39,015
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton)	% sipas rrymave	7,341	7,366	7,391	7,417	7,442	7,467
Organike	52%	3,818	3,831	3,844	3,857	3,870	3,883
Letër+Karton	10%	734	737	739	742	744	747
Plastike	11%	808	810	813	816	819	821
Qelq	5%	367	368	370	371	372	373
Tekstil	5%	367	368	370	371	372	373
Hekur	1%	73	74	74	74	74	75
Inerte	7%	514	516	517	519	521	523
Sanitare	3%	220	221	222	222	223	224
Të tjera	6%	440	442	443	445	447	448

Tabela 7 Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve

Nga parashikimi pritet që të rritet sasia e letrës, plastikës, dhe e mbetjeve jo të degradueshme (p.sh., metali dhe qelqi). Nga ana tjetër, këto rritje mund të rrisin vlerën kalorifike dhe potencialin riciklues të mbetjeve të prodhuara. Në të njëjtën kohë, sasi të relative të gjetheve, drurit, tokës dhe hirit kanë gjasa të jenë të njëjta dhe më së shumti të rriten në disa raste për shkak të tipologjisë së shtëpive dhe ndërtesave të ulta (shtëpi private).

3.4. Infrastruktura për grumbullimin, transportin dhe depozitimin final të mbetjeve

NJA Koplík: Në territorin e NJA Koplík janë të përcaktuara 26 PGM (*Pika Grumbullimi Mbetjesh*), të cilat janë të pajisura me nga 2 kontenerë secili. Në total në të gjithë territorin e njësisë, ku ofrohet shërbimi janë të shpërndarë 76 kontenerë metalik 1.1 m³. Sipas të dhënave të marrë nga përfaqësuesit e bashkisë, 39 janë të dëmtuar dhe kanë nevojë për t'u ndërruar, ndërsa 10 prej tyre janë në gjëndje të mirë me një moshë 2-vjeçare. Kjo njësi e ofron vetë shërbimin e mbetjeve dhe përdor një makinë teknologjike 7 ton, e cila është në gjëndje jo të mirë pune; nga përfaqësuesit e NJA raportohet që defektet e këtij mjeti janë të herë pas hershme. Mbetjet pasi grumbullohen në territorin e NJA Koplík depozitohen në vend grumbullimit e mbetjeve në vendin e quajtur Përroi i Thatë, i cili ndodhet 3km larg qendrës së qytetit. Makina teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në Koplík, kryen mesatarisht në ditë **30 km/ditë** (30x6 = **180 km në javë**).



Figura 7 Shpërndarja aktuale e konteinerëve në NJA Koplík

NJA Shkrel

Në këtë njësi janë të vendosur 68 kontenier në 25 PGM 1.1m³ metalik me kapak (shumë pak kanë nevojë për servis). Kjo njësi disponon 2 makina 7 ton, njëra prej tyre nuk është në funksionim ndërsa tjetra, e cila operon është e amortizuar. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve kryhet 3 herë në javë. Makina kryen mesatarisht 60km/ditë për grumbullim dhe transport mbetjesh (mesatarisht 180km/javë). Mbetjet depozitohen në vend-grumbullimin 3km larg NJA Koplík tek Përroi i Thatë.

NJA Gruemirë: Në territorin e kësaj njësie që prej muajit Prill 2016 ka filluar shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Në projekte të mëparshme kjo NJA ka përfituar një sasi prej 90 kontenierë 1.1 m³, nga të cilët janë vendosur 63 copë (të ndarë në 57 pika grumbullimi) duke mbuluar rreth 80% të territorit të njësisë. Shërbimi për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve kryhet nga makina teknologjike që pastron njësinë e Koplíikut.



Figura 8 Grumbullimit të mbetjeve në NJA Gruemirë përpara vendosjes së kontenierëve

NJA Qendër: Në territorin e kësaj njësie nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Gjatë vizitave në terren dhe intervistave me përfaqësues të bashkisë konstatohet se mbetjet në këtë NJA depozitohen në vendgrumbullime ilegale (përgjatë Përroit të Thatë, pranë shtëpive të banimit etj) dhe shihen me sy të lirë në pjesë të ndryshme të territorit të kësaj NJA.



Figura 9 Pikat e grumbullimit të mbetjeve në NJA Qendër

NJA Kastrat: Në këtë njësi shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve kryhet në rreth 58% të zonës. Në territorin e kësaj njësie janë të shpërndarë 90 kontenierë metalik 1.1m^3 (në gjëndje plotësisht të dëmtuar), përkatësisht 1 për çdo PGM. Për grumbullimin e tyre shërben një kompaktor Skania 7 ton në gjëndje pune mesatare. Mbetjet depozitohen në vend-grumbullimin 3km larg qytetit NJA Koplík tek Përroi i Thatë.

NJA Kelmend: Në këtë njësi shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve kryhet në rreth 84% të zonës. Në territorin e kësaj njësie janë të shpërndarë 16 kontenierë metalik 1.1m^3 me kapak, përkatësisht 1 për çdo PGM. Për grumbullimin e tyre shërben një kamionçinë Benz 1.1 ton në gjëndje pune mesatare.

Zonat e largëta dhe të varfra

1. Në NJA Qendër shërbimi ofrohet në të gjithë fshtarta përveç fshatit Drogovojë (infrastruktura e dobët dhe numri i vogël i familjeve).
2. Në NJA Gruemirë nuk mund të ofrohet shërbimi në këto fshatra: Vajush, Duke, Gjorme i Sipërm, Egc, Lepurosh, Meshqerraj, Linaj, Kurtaj, Rrjoll, Lopç etj. (infrastruktura e dobët dhe numri i vogël i familjeve).
3. Në NJA Kastrat nuk mund të ofrohet shërbim në këto fshatra: Rragam, Skaq, Kastrat, Kosan, Goraj-Gudish (infrastruktura e dobët dhe numri i vogël i familjeve).
4. Në NJA Shkrel nuk mund të ofrohet shërbim në këto fshatra: Rec, Lohe, Qaf-Grade, Repisht (infrastruktura e dobët dhe numri i vogël i familjeve).
5. Në NJA Kelmend ofron shërbim vetëm në dy fshatra Tamarë edhe Qafë-Predeleci, të cilat janë edhe njësitë më të populluara.
6. Në NJA Koplík ofrohet shërbim në të gjithë territorin.

3.5. Shërbimet e mbetjeve

3.5.1. Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenierëve publikë si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenierëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit. Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin pjesën më të madhe të zonës urbane (rreth 90%), kryesisht në akset kryesorë të rrugëve ku janë të pozicionuar pjesa më e madhe e kontenierëve.

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbetjeve (PGM) përbëhet nga kontenierë metalik me rrota me volum 1.1m^3 , të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritet bashkiake. Largësitë mesatare midis PGM variojnë nga çdo 100ml në zonën e qendrës ku është e përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit, në 200-400ml. Në këto pika informale, të paautorizuara, grumbullohen si mbetjet urbane ashtu

dhe inerte dhe voluminoze, duke u kthyer në problematikë të ndotjes urbane, si nga ana vizive ashtu dhe në lidhje me shëndetin publik dhe mjedisin përreth. Njëkohësisht ekzistojnë pak pika individuale ku kontenierët janë të pozicionuar brenda territoreve të institucioneve apo subjekteve private.

Gjëndja aktuale PGM paraqitet e pranueshme, megjithëse ekziston një seri problemesh si për sa i përket dëmtimeve (rreth 10 kontenierë të dëmtuar), higjenës së tyre dhe numrit të pamjaftueshëm të kontenierëve. Ky i fundit është shkaku kryesor në vonesat dhe reduktimin e efektivitetit dhe efikasitetit të shërbimit për grumbullimin e mbetjeve urbane. Kjo situatë shkakton një pamje urbane dhe erë të pakëndshme, e cila shoqërohet me kosto të gjithanshme për mbledhjen e mbetjeve dhe nivel të dobët shërbimi.

Aktivitetet e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve lidhen me procesin e zbrazjes së kontenierëve me anë të makinës teknologjike dhe grumbullimit të mbetjeve përreth kontenierëve. Itenerari dhe frekuenca e përzgjedhur për grumbullimin e mbetjeve urbane paraqitet efektive, duke marrë në konsideratë tipologjinë urbane të bashkisë.

Siç u nënvizua më lart, numri i pamjaftueshëm i kontenierëve, depozitimi i mbetjeve jashtë kontenierëve dhe kultura e ulët qytetare në lidhje me mbetjet dhe mjedisin urban mbeten problematikat kryesore të këtij shërbimi si në drejtim të cilësisë ashtu dhe në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e tij.

3.5.2. Pastrimi i rrugëve

Ky proces konsiston në shërbimin e fshirjes në mënyrë manuale të rrugëve dhe trotuareve kryesore vetëm në NJA Koplík (ruga Nationale) në një volum ditor prej 20,000 m², dhe shërbimi i larjes 2 herë në ditë me makinë larëse të rrugës kryesore me sipërfaqe 12,000 m² për periudhën e verës (1 Maj- 30 Shtator), si dhe pastrimin e 25 koshave të vegjël rrugorë. Fshirja e rrugëve kryhet nga ora 04:00 deri në 07:00 në periudhën e verës dhe 05.30-08.00 për periudhën tjetër të vitit. Ndërsa larja e rrugëve në mëngjes menjëherë pas përfundimit të procesit të fshirjes si dhe në drekë rreth orës 13.00. Për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë të angazhuar me kohë të plotë 2-punëtorë, që punojnë 6 ditë të javës, dhe me kohë të pjesshme (për periudhën e verës) një shofer për larjen e rrugëve.

Në një vëzhgim të përgjithshëm, cilësia e shërbimit të fshirjes dhe larjes mbeten në nivel të pranueshëm, e shoqëruar me një problematikë, ku kryesisht spikat prania e madhe e pluhurit si në rrugët që përfitojnë shërbim ashtu dhe në rrugët e tjera, si dhe praninë e hedhurinave të hedhura kudo që lidhet kryesisht dhe me kulturën e ulët qytetare të komunitetit dhe bizneseve. Shërbimi i larjes së rrugëve nuk sjell ndonjë impakt të konsiderueshëm për minimizimin e pluhurit për shkaqe që lidhen me infrastrukturën, parkimet e përherëshme, dhe me metodologjinë e përdorur për fshirjen dhe larjen e rrugëve. Sipas të dhënave të marra, norma e harxhimit të ujit për larjen e rrugëve është rreth 0.42 litra për m². Uji sigurohet nga liqeni (2.5 km larg nga qendra e qytetit) si dhe nga burime të tjera alternative. (si pusët). Në njësitë e tjera administrative shërbimi i fshirjes dhe larjes së rrugëve nuk kryhet.

3.5.3. Depozitimi

Mbetjet urbane dhe voluminoze që gjenerohen nga NJA Koplík, Kastrat, Shkrel dhe Gruemirë transferohen në vend-depozitim të improvizuar në pjesën veri-perëndimore dhe brenda territorit të NJA Koplík, në një sipërfaqe prej rreth 4 ha (përveç NJA Kelmend e cila nuk i depoziton mbetjet në këtë venddepozitim për shkak të largësisë dhe kostove të larta të transportit, por në dy vende të paautorizuara brenda territorit të saj). Venddepozitimi ndodhet 2.5-3 km nga qendra e qytetit, disa qindra metra larg bregut të Liqenit të Shkodrës, dhe në të njëjtën kohë rreth 18 km nga kufiri kombëtar me Malin e Zi.

Mbetjet urbane dhe voluminoze depozitohen në mënyrë të çrregullt pa asnjë trajtim paraprak për zhvendosjen, mbulimin apo groposjen e tyre apo mirëmbajtjen e fushës. Autoritetet e bashkisë deklarojnë se në këtë fushë depozitohen mesatarisht çdo ditë rreth 7.7 ton mbetje urbane dhe rreth 4.6 ton mbetje voluminoze në ditë, megjithatë kjo sasi nuk është e matur dhe dyshohet të jetë më e lartë. Vendi i depozitimit ndodhet larg zonës së banimit, por nuk ka informacione apo matje lidhur me impaktin e kësaj fushe në shëndetin e banorëve, mjedisit: ujrave sipërfaqëore dhe nëntokësore, tokës, faunës dhe florës përreth.

E vetmja masë që merret për reduktimin e volumit është djegja e pakontrolluar e tyre. Ky venddepozitim nuk është i rrethuar dhe nuk ka asnjë roje për të kontrolluar llojin e mbetjeve që depozitohen në të. Ndërkohë ky venddepozitim ndodhet në kufi të zonës së mbrojtur të kategorisë IV (përcaktuar me VKM Nr.684 i vitit 2005, për shpalljen e rezervat natyror të Liqenit të Shkodrës dhe që përfshin dhe një pjesë të territorit të NJA Koplík).



Figura 10 Venddepozitimi i mbetjeve në NJA Koplík

3.5.4 Riciklimi

Në bashkinë Malësia Madhe aktualisht nuk ekziston ndonjë sistem për mbledhjen në mënyrë të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme apo praninë e qendrave për grumbullimin e tyre. Nuk ka informacion për ekzistencën e industrisë së riciklimit në qytet, por ekzistojnë aktivitete të vogla informale për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme nga kontenierët publikë, të cilët gërmojnë për materiale të

ricikluara (kryesisht metale, lëndë plastike dhe plastikë LD) në pikat e grumbullimit (duke gërmuar brenda kontainerëve).

3.6. Administrimi i mbetjeve voluminoze

Një faktor tjetër që ndikon në pastërtinë e PGM ashtu dhe në pastërtinë e gjithë qytetit është edhe hedhja pa kriter e mbetjeve voluminoze, kryesisht inerte, degë dhe pajisje voluminoze, të papranueshme për sistemin e mbledhjes së mbetjeve. Mbetjet nga prishja e ndërtimeve apo të ashtu quajturat mbetje të ngurta janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave dhe strukturave të tjera. Shpesh këto mbetje hidhen të përziera me mbetjet urbane duke ndikuar në cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve. Nga bashkia Malësia Madhe raportohet që periodikisht ndërhyet për largimin e mbetjeve inerte duke i dërguar këto në vendepozitim e mbetjeve që ndodhet pranë NJA Koplik. Sipas të dhënave zyrtare, bashkia deklaron se largon rreth 1,500-1,700 ton mbetjeve voluminoze në vit, të cilat përbëjnë rreth 37% të totalit të mbetjeve të ngurta që gjenerohen në qytet (dy herë më e lartë se norma e deklaruar në nivel kombëtar (15-20%). Për këtë qëllim gjenerimi, mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve voluminoze përbën një çështje të rëndësishme për manaxhimin e mbetjeve në jo vetëm në NJA Koplik, por në të gjithë territorin e Bashkisë.

3.7. Ekonomia dhe financimi

3.7.1. Buxheti i shërbimit të pastrimit

Akualisht nuk ka të dhëna të detajuara të buxheti të vitit 2016 mbi menaxhimin e mbetjeve; gjithësesi 6-mujori i parë i vitit të kaluar (2015) na jep një pasqyrë të përafërt lidhur me buxhetin për manaxhimin e mbetje/pastrimit të zonës në administrim të NJA.

Në tabelat më poshtë paraqitet buxheti i NJA të Bashkisë për voton 2015 si dhe niveli i tarifave të mbetjeve të aplikuara ngë NJA në vitin 2015, të cilat vazhdojnë të aplikohen ende:

NJA	Koplik	Gruemirë	Qendër	Shkrel	Kastrat	Kelmend	Total
Buxheti total i bashkisë 2015 (lek)	33,169,000	1,812,600	6,943,000	14,410,000	11,240,000	1,639,500	69,214,100
Buxheti i NJA për shërbimin e mbetjeve 2015 (lek)	5,000,000	0	0		3,800,000	160,000	8,960,000

Tabela 8 Buxheti total i bashkisë kundrejt buxhetit të shërbimit të mbetjeve

Për NJA Koplik është analizuar shpërndarja e buxhetit për pastrimin sipas nevojave dhe kostove të shërbimeve, një analizë e hollësishme e kostove dhe shpërndarjes së buxhetit është bërë nga specialistët e kësaj NJA vetëm gjatë përgatitjes së dokumentacionit për organizimin e tenderit të pastrimit (pra çdo 5-vjet, i fundit në vitin 2009) gjatë analizës së çmimit të kontratës apo në rastet kur parashikohet në kontratë rishikim i këtij çmimi. Për njësitë e tjera nuk ka të dhëna për këtë qëllim. Duke iu referuar analizës së

fundit të çmimit të kontratës për NJA Koplík, shpërndarja e shpenzimeve ilustron në tabelën e mëposhtme:

Zërat e buxhetit të pastrimit	Periudha 2010-2015	%
Pagat + sigurimet shoqërore (000 lek)	2,700	62.8%
Shpenzimet e materialeve (000 lek)	542	12.6%
Shpenzime për mirëmbajtje (000 lek)	560	13%
Shpenzime administrative	500	11.5%
Totali (000 lek)	4,302,000	

Tabela 9 Alokimi i kostove sipas kontratës së pastrimit

Siç mund ta shikojmë edhe nga të dhënat e tabelës përqindjen më të madhe të kostove të shërbimit të mbetjeve e zënë kostot operative të burimeve njerëzore (paga dhe sigurimet shoqërore).

3.7.2. Tarifat dhe realizimi i të ardhurave

Aktualisht në territorin e Bashkisë Malësia Madhe në të gjithë njësitë administrative aplikohet ende sistemi i tarifave të përdorura nga vetë njësitë para reformës territoriale. Në tabelën më poshtë jepen nivelet e tarifave që aplikohen në NJA të bashkisë për të gjithë kategoritë e konsumatorëve.

NJA	Koplík	Gruemirë	Qendër	Shkrel	Kastrat	Kelmend
Tarifa pastrimit për familjet 2016 (lek)	3,000	700	500	500	1,500	1,000
Tarifa e pastrimit për BV 2016 (lek)	2,500	9,000	1,500	6,000	6,000	1,500
Tarifa e pastrimit për BM 2016 (lek)	60,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000
Tarifa e pastrimit për Institucionet 2016 (lek)	4,000	-	-	-	5,000	-

Tabela 10 Niveli i tarifave të pastrimit për NJA të Bashkisë Malësia Madhe




Figura 11 Niveli i tarifave të pastrimit në Bashkinë Malësia Madhe

Nga të dhënat e tabelës kuptojmë që NJA Koplík ka nivelin më të lartë të tarifës së pastrimit për kategorinë e familjeve, e ndjekur më pas nga NJA Kastrat dhe më pas Kelmend. Në dy njësitë ku para Prill-it të vitit 2016 nuk ofrohej shërbimi (Gruemirë dhe Qendër) ish Komunitat kishin vendosur një tarifë pastrimi, e cila në të shumtën e rasteve nuk mblidhej asnjëherë nga ish Komunitat.

Në tabelën më poshtë jepet një pasqyrë e realizimit të të ardhurave nga mbledhja e tarifës në të gjitha NJA të bashkisë gjatë vitit 2015:

Bashkia Malësia Madhe	Planifikimi familjet 2015	Realizimi familjet 2015	Planifikimi BV 2015	Realizimi BV 2015	Planifikimi BM 2015	Realizimi BM 2015	Planifikimi Institucionet 2015	Realizimi Institucionet 2015
Planifikimi/Realizimi (lek)	18,740,500	11,810,000	1,459,500	343,000	93,570,000	560,000	36,017	-
Realizimi (%)	63%		24%		0.6%		0%	

Tabela 11 Realizimi i të ardhurave në Bashkinë Malësia Madhe gjatë vitit 2015

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se shkalla më e lartë e pagesës së tarifës së pastrimit vjen nga familjet në masën 63% të numrit të parashikuar, duke u ndjekur nga biznesin e vogël në shkallën 24% dhe nga biznesi i madh në vetëm 0.6%.




Figura 12 Realizimi i të ardhurave

Nuk ka informacion për tarifën përgjatë vitit 2016 por ajo që vërehet është disniveli i lartë midis pagesës nga ana e familjarëve dhe shkalla e ulët nga bizneset të cilat janë dhe kontribues të rëndësishëm sa i takon gjenerimit të mbetjeve. Në total shumica e planifikuar për të mbledhur nga tarifën e pastrimit përgjatë 2015 për të gjitha NJA e bashkisë së Malësisë së Madhe ka qenë 113,806,017 Lek ndërsa shumica e realizuar është 12,713,000 ose 11 % e vlerës së planifikuar.

4. Planifikimi lokal i menaxhimit të Mbetjeve

4.1. Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Malësi Madhe mori formë si një proces i analizimit të situatës aktuale, diskutimit dhe konsultimeve me palët e interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Kryetari Bashkisë Z. Tonin MARINAJ, grupi i punës nga Metropolis/Co-PLAN dhe Grupi i punës i dldp Helvetas Inter-Cooperation).

Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioritetëve të përgjithshme dhe konkrete në kuadrin e ndarjes së re administrative si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

“Bashkia e Malësisë Madhe një zonë me një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, ku shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet sipas standardeve të larta dhe ku aplikohen skemat e reja 3R për mbetjet”.

Qëllimi kryesor:

“Një zonë e pastër drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe turistik”

4.2. Objektivat

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Mbetjeve kanë përcaktuar 3 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2010-2015 dhe 2015-2020) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe faza e tretë (2020-2025) ku synohet arritja e standardeve dhe objektivave të BE.

Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradualisht drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Në fazën e parë (para-pranimit), plani do të adresojë nevojat lokale për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Fokusi në këtë fazë do të jetë në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës bashkiake për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit si dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara. Manaxhimi në nivel lokal do të përfshijë zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për dorëzim final në landfill. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave bashkiake për manaxhimin e mbetjeve.

Në fazën e dytë (faza e pas pranimit) synimet do të jenë në arritjen e objektivave strategjike kombëtare, në përputhje me standardet e legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe principet për të minimizuar sasinë e mbetjeve që shkojnë në *landfill*.

4.3. Objekti i Planit

Në vijim të përmbushjes të vizionit të planit si dhe synimeve të Bashkisë për përmbushjen e objektivave kombëtare, u përcaktuan objektivat lokale për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, si më poshtë:

- Mbulimi i të gjithë territorit të bashkisë Malësia Madhe me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- Përmirësimi i shërbimeve të pastrimit në të gjitha NJA ku ky shërbim ofrohet aktualisht;
- Ofrimi i shërbimeve të mbetjeve eficiente dhe efikase;
- Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrëveshjeve dhe kontratave;
- Krijimi një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investimet e nevojshme);
- Mbyllja e fushës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve dhe gjetja e zgjidhjeve mjedisore dhe ekonomike në zbatim të politikës kombëtare dhe rajonale në depozitimin e mbetjeve;
- Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze;
- Parandalimi i rrezikut nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe mjeksore) në zbatim të legjislacionit shqiptar;
- Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe ndërkufitar për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij;
- Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u berë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të qytetit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve;
- Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot;
- Relazimi i objektivave kombëtare për minimizimin e mbetjeve në nivel lokal.

4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake për të cilën Bashkia Malësia Madhe është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet urbane ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industrinë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë, rryma të tjera mbetjes klasifikohen si mbetje masive, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet që zona e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë të ndahen në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshaten më mirë me qëllim e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

1. **Nën-zona e parë:** Në këtë nën-zonë do të kategorizojmë zonat me dendësi të lartë popullesie si dhe zonat me tipare të ngjashme me zonat urbane. Referuar metodologjisë së DLDP, për këtë zonë do të konsiderojmë kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve çdo ditë (7 herë/javë). PGM do të jenë të shpërndarë në mënyrë uniforme kryesisht çdo 100-150 m nga njëri-tjetri. Konkretisht në nën- zonën e parë të mbetjeve do të jetë NJA Koplík dhe pjesët urbane të njësive të tjera, ku janë të përqendruar zonat e banuara dhe njësitë tregtare.
2. **Nën-zona e dytë:** kjo nën-zonë do të kategorizohen nga pjesë të territorit me tipare rurale fushore me numër jo të lartë banorësh, ku shërbimi parashikohet të kryhet mesatarisht 2-3 herë në javë dhe distanca midis PGM do të jetë 200 m larg njëri tjetrit.
3. **Nën-zona e tretë:** do të kategorizohen zonat malore apo ato të thella dhe me dendësi të ulët popullesie. Në këto zona shërbimi do të jetë i rrallë (1 herë në javë ose 2-3 herë në muaj në varësi të sasisë dhe distancave) dhe distanca e PGM do të jetë mbi 300 m.

4.4. Evidentimi i alternativave për administrimin e mbetjeve

Një element thelbësor i planifikimit të manaxhimit të mbetjeve është “identifikimi dhe shqyrtimi i alternativave”. Kjo gjë konsiston në konsiderimin e mundësive të ndryshme teknike dhe strategjike për manaxhimin e mbetjeve sipas kapitujve kryesorë, vlerësimit të shkallës së zbatimit të tyre, avantazheve dhe disavantazheve ekonomike, ligjore, mjedisore, sociale si dhe teknologjive në dispozicion për këto alternativa.

4.4.1. Shërbimet e pastrimit të rrugëve

Synimi i bashkisë konsiston në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe në rritjen e zonës të mbuluar me shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shesheve, duke përfshirë gjithë zonën urbane të bashkisë Malësia Madhe. Aktualisht, mbulohet me shërbim fshirje vetëm NJA Koplík në një sipërfaqje prej 20,000m² rrugë si dhe me larje rrugesh një sipërfaqje prej 12,000 m²/ditë (gjatë sezonit të verës) në NJA Koplík.

Pastrimi i akseve rrugore në zonat me dendësi mesatare urbane: Megjithëse në këto zona mungon shërbimi i pastrimit, ato nuk paraqesin ndonjë problematikë lidhur me papastërtinë e hapësirave publike nga mbetjet. Rekomandohet që kjo zonë të përfshihet në volumet e punës për fshirje me punëtorë në një frekuencë mesatare 1 herë në javë. Norma e rekomanduar për pastrimin e këtyre zonave varion në 16,000-20,000 m²/punëtor/ditë. Konkretisht këto zona përfshijnë zonat urbane në njësitë e tjera administrative si qyteza e Bajzës, ku bashkia aktualisht ka filluar të testojë ofrimin e këtij shërbimi, si dhe zonat urbane në Shkrel, Gruemirë apo Kelmend (kryesisht zonat turistike).

Pastrimi i akseve rrugore në zonat me dendësi të ulët urbane si dhe në zonat me infrastrukturë të dëmtuar: Duke synuar shtrirjen e shërbimit të pastrimit edhe në këto zona me dendësi të ulët urbane dhe me infrastrukturë të dëmtuar, bashkia synon të mundësojë një hapësirë urbane të pastër dhe të lirë nga ndotja pa shpenzime të tepërta financiare. Kjo do të thotë se bashkia mund të organizojë shërbime të pastrimit (fshirje apo grumbullim mbetjesh) në një frekuencë mujore (2-3 herë në muaj). Norma e rekomanduar për pastrimin e këtyre zonave varion në 16,000-20,000m²/punëtor/ditë.

Organizimi i shërbimeve të pastrimit duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrim të rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh. Për këtë qëllim frekuencat e propozuara më lart për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi deri në përcaktimin përfundimtar në specifikime teknike të mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

1. **Kategoria e Parë:** (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes; është më i parapëlqyer pastrimi me makinë teknologjike i akseve kryesore (kur është e mundshme dhe

ka efektivitet), por dhe mirëmbajtja e tyre gjatë ditës, vendosja dhe pastrimi ditor i koshave rrugore, si dhe shërbim i larjes gjatë verës;

2. **Kategoria e dytë:** (rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtar) fshirja manuale e rrugëve është e nevojshme të kryhet çdo ditë të javës.
3. **Kategoria e tretë:** (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor pastrimi (fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh).

4.4.2. Mbledhja e mbetjeve

Duke iu referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar mbetet brenda nivelit mesatar, të krahasueshëm në nivel kombëtar. Megjithatë Bashkia Malësia Madhe është e motivuar dhe e angazhuar të përmirësojë këtë situatë duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual të ofrimi të shërbimit në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve.

Duke kaluar në një përfaqje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”, sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i bashkiak për mbledhjen e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për mbledhjen e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të vendoset në një kontenier mbetjesh (zakonisht $1.1m^3$) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të mbledhjes së mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë më shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum $1.1m^3$ (që përdoren aktualisht në NJA Koplík, Grumerirë, Kastrat si dhe gjerësisht të përdorëshëm në vend dhe rajon), rekomandohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në këtë bashki. Gjithashtu rekomandohet që kontenierët të jenë metalik dhe me vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe me sistem rrotash të qëndrueshëm, me kapakë për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga impakti i faktorëve të jashtëm. Gjithashtu mosndryshimi i tipit aktual të kontenierëve minimizon fondet e

nevojshme për përmirësimin e skemës. Ndërkohë bazuar në sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe frekuencës të ofrimit të shërbimit, në rastin e Bashkisë Malësia Madhe makina teknologjike me kapacitet 10 ton është parë si më e përshtatshme për ofrimin e shërbimit në mënyrë sa më efektive. Në variantet më poshtë të prezantuar për grumbullimin e mbetjeve, jepet më qartë kjo analizë:

SKENARI I

Skenari 1 merr në konsideratë shtrirjen e shërbimit në 100% të territorit të Bashkisë. Nga llogaritjet e kryera në tabelën më poshtë jepet numri i kontenerëve të nevojshëm për të gjitha NJA në Bashki. Është supozuar që Bashkia duhet të parashikojë blerjen e një mjeti teknologjik 10 ton dhe riparimin e mjeteve ekzistuese (7 ton-she), duke e çuar në 3 (2 nga 7 ton ekzistuese) numrin e mjeteve në përdorim dhe 1 mjet rezervë. Secila nga NJA do të ketë frekuencën përkatëse të grumbullimit të mbetjeve, të cilat më pas do të depozitohen në venddepozitimin e NJA Koplík aktual. Kjo skemë e mbledhjes dhe largimit të mbetjeve është një vazhdim i skemës aktuale dhe mbështetet në një sistem të përbashkët të grumbullimit të mbetjeve, ku konsumatorët janë të detyruar të largojnë mbetjet urbane ditore ose të një periudhe të caktuar pranë pikave të miratuara (PGM). Në tabelën më poshtë jepet llogaritja optimale për nevojën për kontenerë 1.1m³ që ka i gjithë territori i Bashkisë Malësia Madhe. Aktualisht kjo bashki, sipas skenarit I ka nevojë për 374 kontenerë, nga 256 që ka aktualisht, ku një pjesë e mirë në NJA Kastrat jën për t'u zëvendësuar plotësisht. Territori në këtë skenar do të ndahet në 3 zona ku makinat do ti shërbejnë të ndara NJA-ve. Përrjashtim bën NJA Gruemirë, ku për të rritur eficiencën e makinës 10 ton, që shërben Koplíkun, gjatë shërbimit mund të zgjedhë rrugë të NJA Gruemirë për të kryer shërbimin. Skenari do të ndahet në këto zona sipas numrit të popullsisë:

Zona 1: Koplík+Shkrel+Kelmend+ ½ e NJA Gruemirë = 19,452 banorë (makina 10 Ton).

Zona 2: NJA Qender+ 1/2 Gruemirë = 10,367 banorë (makina 1 - 7 Ton).

Zona 3: NJA Kastrat 8,538 banorë makina (2) 7 Ton.

Për zonën 1 do të mesatarizohet sasia e gjeneruar e mbetjeve/banor në 0.57 kg/banor/ditë

Për zonat 2 dhe 3 do të jetë 0.35 kg/banor/ditë.

NJA/ Varianti I	Nr. Popullsisë	Sasia e mbetjeve	Sasia mesatare vjetore	Frekuenca e proponuar	Densiteti mesatar i mbetjeve urbane	Kapaciteti i kontenierëve	Koeficienti i mbushjes	Nevoja për kontenierë
	nr.	ton/vit	ton/ditë	ditë/javë	ton/m ³	m ³	%	no.
Koplík	5,898	2,303	6.3	7	0.125	1.1	85%	53
Grumeirë	10,337	1,586	4.3	3	0.125	1.1	85%	85
Qender	5,199	734	2.0	2	0.125	1.1	85%	59
Shkrel	4,312	612	1.7	2	0.125	1.1	85%	49
Kastrat	8,538	1,517	4.2	3	0.125	1.1	85%	81
Kelmend	4,074	589	1.6	2	0.125	1.1	85%	47
Total	38,358	7,341	20.1					374

Tabela 12 Llogaritja e nevojës për kontenier për Skenarin I

Ndërkohë në tabelën më poshtë jepet edhe një kalendar i mundshëm i lëvizjes së makinave sipas këtij skenari:

NJA/ Varianti I	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
Koplik	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)	Makina 10 ton - turni 1 (26+4)
Grumeirë		Makina 10 ton turni 2 (30) + Makina 7ton rruga 1 (21)		Makina 10 ton turni 2 (30) + Makina 7ton rruga 1 (21)		Makina 10 ton turni 2 (30) + Makina 7ton rruga 1 (21)	
Qender	Makina 7ton/1 turni 1 (21)				Makina 7ton/1 turni 1 (21)		
Shkrel			Makina 10 ton - turni 2 (27)				Makina 10 ton - turni 2 (27)
Kastrat		Makina 7 ton/2 - 2 turne (36 pika)		Makina 7 ton/2 - 2 turne (36 pika)		Makina 7 ton/2 - 2 turne (36 pika)	
Kelmend	Makina 10 ton - turni 2 (28 pika)				Makina 10 ton - turni 2 (28 pika)		

Tabela 13 Kalendar i mundshëm i lëvizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve – Skenari 1

KOSTO PËR BANORË, ZONA 1, Skenari 1


Zonat

1

4

Zona e shërbimit Zona 1

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] 14,004,033.34




Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
Grumbullim	137 Lek	0.98 €
Transport	172 Lek	1.24 €
Mirëmbajtje	38 Lek	0.27 €
Personel	199 Lek	1.43 €
Amortizim	81 Lek	0.58 €
Depozitim	94 Lek	0.68 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	720 Lek	5.18 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
Grumbullim	657 Lek	4.73 €
Transport	826 Lek	5.94 €
Mirëmbajtje	181 Lek	1.31 €
Personel	955 Lek	6.87 €
Amortizim	389 Lek	2.80 €
Depozitim	452 Lek	3.25 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	3,460 Lek	24.89 €

KOSTO PËR BANORË, ZONA 2, Skenari 1

Zona e shërbimit	Zona 2
<i>Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit]</i>	4,902,717.32




Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
<i>Grumbullim</i>	59 Lek	0.43 €
<i>Transport</i>	67 Lek	0.48 €
<i>Mirëmbajtje</i>	64 Lek	0.46 €
<i>Personel</i>	149 Lek	1.07 €
<i>Amortizim</i>	76 Lek	0.55 €
<i>Depozitim</i>	58 Lek	0.42 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	473 Lek	3.40 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
<i>Grumbullim</i>	462 Lek	3.33 €
<i>Transport</i>	523 Lek	3.76 €
<i>Mirëmbajtje</i>	499 Lek	3.59 €
<i>Personel</i>	1,167 Lek	8.39 €
<i>Amortizim</i>	598 Lek	4.30 €
<i>Depozitim</i>	452 Lek	3.25 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	3,702 Lek	26.63 €

KOSTO PËR BANORË, ZONA 3, Skenari 1

Zona e shërbimit	Zona 3
<i>Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit]</i>	4,616,129.77



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
<i>Grumbullim</i>	72 Lek	0.52 €
<i>Transport</i>	64 Lek	0.46 €
<i>Mirëmbajtje</i>	77 Lek	0.56 €
<i>Personel</i>	181 Lek	1.30 €
<i>Amortizim</i>	89 Lek	0.64 €
<i>Depozitim</i>	58 Lek	0.42 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	541 Lek	3.89 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
<i>Grumbullim</i>	562 Lek	4.04 €
<i>Transport</i>	499 Lek	3.59 €
<i>Mirëmbajtje</i>	606 Lek	4.36 €
<i>Personel</i>	1,417 Lek	10.19 €
<i>Amortizim</i>	697 Lek	5.01 €
<i>Depozitim</i>	452 Lek	3.25 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	4,232 Lek	30.45 €

E përmbledhur për të gjithë territorin e Malësisë së Madhe kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për skenarin 1 do të jete:

SKENARI 1 (pa modifikim levizje), depozitim ne venddepozitim aktual				
Viti	Kosto e manaxhimit Zona 1 (lek/vit)	Kosto e manaxhimit Zona 2 (lek/vit)	Kosto e manaxhimit Zona 3 (lek/vit)	Totali (lek/vit)
2017	14,004,033	4,902,717	4,616,130	23,522,880
2018	14,012,149	4,905,536	4,618,320	23,536,005
2019	14,020,266	4,908,003	4,620,509	23,548,778
2020	14,028,382	4,910,646	4,622,699	23,561,727
2021	14,036,498	4,913,364	4,624,889	23,574,751

Tabela 14 Kosto e plotë – Skenari 1

Mjeti	rruge/jave	rruge/vit
10 ton	14	728
7 ton mak 1	5	260
7 ton mak 2	6	312

SKENARI II

Në variantin e dytë parashikohet ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, duke blerë një makinë 10 ton dhe duke përdorur një nga mjetet që punojnë aktualisht në një nga NJA të kësaj bashkie. Shërbimi në këtë variant do të ofrohet në pjesën më të madhe të territorit të bashkisë (rreth 90%), duke lënë jashtë vetëm zonat shumë të varfra dhe të largëta (kontretisht disa fshatra të NJA Shkrel dhe Kelmend). Në këto njësi do të parashikojmë vendosjen e 30 kontenierëve 1.1m³. Kjo skemë do të funksionojë sipas një planifikimi të shërbimit, ku zona do të konsiderohet si e një e tërë dhe lëvizshmëria e mjeteve do të bëhet duke zgjedhur rrugët më të shkurtra dhe jo sipas NJA si në variantin e parë. Në këtë variant Bashkia Malësia Madhe është ndarë në dy zona kryesore **në varësi të tipologjisë sa banimit dhe sasisë së mbetjeve që gjenerohet**: i) **Zona 1** (NJA Koplik, NJA Gruemirë, NJA Kastrat); **Zona 2** (Qendër, Shkrel, Kelmend). Nisur nga norma e gjenerimit të mbetjeve të përmendur pak më lart, nga një mesatarizim i tyre, në tabelën më poshtë jepen vlerat e gjenerimit të mbetjeve për këto dy zona të variantit II:

Sasia teorike e mbetjeve te gjeneruara(ton/vit)							zona 1 (kg/banor/dite) e mesatarizuar	zona 2 (kg/banor/dite) e mesatarizuar
NJA	kg/banor/dite	banore	biznesi i madh	biznesi i vogel	institucione	kg/banor/dite /NJA	0.57	0.39
NJA Koplik	0.70	1,506.94	104.03	654.81	27	1.01		
NJA Gruemire	0.35	1,509.20	54.75	140.16	50	0.46		
NJA Qender	0.35	664.17	10.95	39.42	14	0.38		
NJA Shkrel	0.35	550.86	10.95	19.71	22	0.38		
NJA Kastrat	0.35	1,090.73	60.23	162.06	34	0.43		
NJA Kelmend	0.35	520.45	16.43	21.90	22	0.39		

Tabela 15 Norma e gjenerimit për dy zonat e ofrimit të shërbimit

Duke supozuar që Bashkia Malësia Madhe është e ndarë në këto dy zona, të cilat kanë përkatësisht këto norma gjenerimi, në tabelën më poshtë është bërë llogaritja e kontenerëve të nevojshëm për këto dy zona, ku NJA janë shkrirë si një e tërë, 3 për secilën zonë:

Llogaritja e kontenerëve të nevojshëm Skenari 2							
NJA	Sasia e mbetjeve	Sasia mesatare vjetore	Frekuenca e propozuar	Densiteti mesatar i mbetjeve urbane[1]	Kapaciteti i kontenerëve	Koeficienti i mbushjes	Nevoja për konteniere
	ton/vit	ton/ dite	dite/ jave	ton/m3	m3	%	nr.
NJA Koplík	2,292	6.28	7	0.125	1.1	85	50
NJA Gruemire	1,754	4.81	7	0.125	1.1	85	40
NJA Qender	729	2.00	2	0.125	1.1	85	58
NJA Shkrel	603	1.65	2	0.125	1.1	85	48
NJA Kastrat	1,347	3.69	7	0.125	1.1	85	31
NJA Kelmend	581	1.59	2	0.125	1.1	85	47
Total							275

Tabela 16 Nevoja për konteniere sipas Variatit II

Siç mund ta shohim, në këtë variant numri total i kontenerëve të nevojshëm, sipas vlerësimit teorik të normës së gjenerimit të mbetjeve, është 275 konteniere. Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve është përcaktuar të jetë 7 ditë në javë për Zonën 1 (makina që do të blihet 10 ton) dhe 2 ditë në javë për Zonën dy (një nga makinat ekzistuese). Në tabelën më poshtë jepet kalendari i mundshëm i lëvizjes së mjeteve në këtë variant:

NJA/ Varianti II	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
Koplík	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1
Gruemirë	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2	Makina 10 ton - turni 2
Qender	Makina 7 ton				Makina 7 ton		
Shkrel		Makina 7 ton					Makina 7 ton
Kastrat	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1	Makina 10 ton - turni 1
Kelmend			Makina 7 ton			Makina 7 ton	

Tabela 17 Kalendari i mundshëm i lëvizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve – Varianti II

Nisur nga ky kalendar shohim se mjete 10-ton do të kryejë 14 rrugë/javë (728 rrugë/vit), ndërsa mjete 7ton do të kryejë 6 rrugë/ javë (312 rrugë/vit).


KOSTOT E SHËRBIMIT PËR SKENARIN II

ZONA 1

NJA Koplík, Gruemire, Kastrat (Zona 1), ku shërbimi do të kryhet nga makina 10 ton, 7 ditë në javë, në total do të ketë këto kosto të menaxhimit të mbetjeve. E ndarë sipas përberësve kjo kosto jepet sipas grafikëve dhe tabelave të mëposhtme:

Zona e shërbimit | Zona 1

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **11,225,336.68**



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

<i>Grumbullim</i>	107 Lek	0.77 €
<i>Transport</i>	27 Lek	0.19 €
<i>Mirëmbajtje</i>	30 Lek	0.21 €
<i>Personel</i>	124 Lek	0.89 €
<i>Amortizim</i>	70 Lek	0.50 €
<i>Depozitim</i>	94 Lek	0.68 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	451 Lek	3.25 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit


<i>Grumbullim</i>	514 Lek	3.70 €
<i>Transport</i>	129 Lek	0.93 €
<i>Mirëmbajtje</i>	142 Lek	1.02 €
<i>Personel</i>	597 Lek	4.30 €
<i>Amortizim</i>	335 Lek	2.41 €
<i>Depozitim</i>	452 Lek	3.25 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	2,169 Lek	15.61 €

ZONA 2

Kosto për NJA Qendër, Shkrel dhe Kelmend (Zona 2), ku shërbimi do të kryhet nga makina 7 ton 7 ditë në javë, në total do të ketë këto kosto të menaxhimit të mbetjeve. E ndarë sipas përberësve kjo kosto jepet sipas grafikëve dhe tabelave të mëposhtme:

KOSTO PËR BANORË, ZONA 2, Skenari 2

Zona e shërbimit	Zona 2
<i>Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit]</i>	9,899,882.51



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
Grumbullim	90 Lek	0.65 €
Transport	232 Lek	1.67 €
Mirëmbajtje	48 Lek	0.35 €
Personel	227 Lek	1.63 €
Amortizim	64 Lek	0.46 €
Depozitim	64 Lek	0.46 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	726 Lek	5.22 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
Grumbullim	631 Lek	4.54 €
Transport	1,632 Lek	11.74 €
Mirëmbajtje	341 Lek	2.45 €
Personel	1,592 Lek	11.45 €
Amortizim	452 Lek	3.25 €
Depozitim	452 Lek	3.25 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	5,099 Lek	36.69 €

E përmbledhur për të gjithë territorin e Malësisë së Madhe kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për skenarin 2 do të jetë:

SKENARI 2 (me modifikim levizje), depozitim ne venddepozitim aktual			
Viti	Kosto e menaxhimit Zona 1 (lek/vit)	Kosto e menaxhimit Zona 2 (lek/vit)	Totali (lek/vit)
2017	11,225,337	9,899,883	21,125,219
2018	11,235,789	9,903,753	21,139,542
2019	11,246,242	9,907,707	21,153,949
2020	11,256,694	9,911,662	21,168,356
2021	11,267,147	9,915,616	21,182,763

Tabela 18 Kosto e plotë – Skenari 2

PROPOZIM PËR INTENERARIN E GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE – Skenari 2

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të grumbullimit dhe transportit lidhen drejtpërsëdrejti me itinerarin e përzgjedhur të lëvizjes së makinës si dhe me kohën efektive të punës gjatë ndalesave në çdo PGM. Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve. Këta elementë janë marrë parasysh gjatë “Analizës së infrastrukturës së mbetjeve”, cituar më lart. Më konkretisht, duke minimizuar hedhjen e mbetjeve në tokë pranë PGM, mbingarkesën e kontenierëve apo eliminimin e pikave të hapura (kryesisht ilegale) mund të reduktojë kohën e punës për një rrugë të plotë (mbushje të plotë të makinës) nga 2-3 herë.

Për të përmirësuar kohën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duhet të merren në shqyrtim itineraret aktualë në zbatim të parimeve të listuara më poshtë:

- Itineraret duhet të zgjidhen sipas rrugëve më të shkurtra dhe të përshtatshme (është modeluar lëvizshmëria e mjeteve duke analizuar rrugët më të shkurtra me programin në ARC-GIS).
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë autoparkut të mjeteve që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Në PGM të grupuara në pjesët urbane, përvoja ka treguar që ka shpesh mbetje jashtë kontenierit. Për këtë arsye, rekomandohet që punëtorët të shkojnë përpara makinës dhe t'i hedhin mbetjet në kontenier përpara se të mbërrijë makina;
- Nuk duhet të kryhet grumbullimi i mbetjeve në PGM që janë në rrugët trafik të madh gjatë orëve të pikut;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo siguron mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant;

- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.

Në hartat më poshtë jepen propozimet e lëvizjes së makinave për të dy zonat e Variantit 2:

ZONA 1



levizshmeria e makines 10 T turni 2




Figura 13 Lëvizja e makinës 10 në turni 2 – Varianti 2



levizshmeria e makines 10 T turni 1




Figura 14 Lëvizja e makinës 10 në turni 1 – Varianti 2

ZONA 2



levizshmeria e makines 7 (NJA Kelmend)



Figura 15 Lëvizja e makinës 7 ton në NJA Kelmend – Varianti 2



levizshmeria e makines 7 (turni 1 Qender)





levizshmeria e makines 7 (turni 2 Qender)




Figura 16 Lëvizja e makinës 7 ton në NJA Qender – Varianti 2

Parandalimi i ndotjes: Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për manaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të hartojë:

- Një rregullore vendore për manaxhimin e mbetjeve, të përcaktojë rregullat dhe gjobat përkatëse. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontinierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje të mirë me konsumatorët e mëdhenj, etj., për të sqaruar përgjegjësitë dhe detyrimet, rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve

(i) Orare pune efektive dhe të përshatshme: Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.

(ii) Numri i duhur i kontenierëve: Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve (mund ti referohet dhe rekomandimeve të këtij raporti).

(iii) Itinerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve: Përcaktimi i saktë i itinerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Planifikimi i itinerareve duhet të ndjekë parimet që u shtjelluan më sipër. Për më tepër rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itinerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM).

(iv) Rritja e rendimentit në punë: Bashkia apo kompania private duhet të gjejë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.

(v) Mirëmbajtja e përshatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve: Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.

4.4.3. Mbledhja e diferencuar e mbetjeve

Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve ka përcaktuar disa indikatorë në lidhje me sasinë e mbetjeve që duhet të riciklohen, kompostohen sipas afateve kohore.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbetjeve si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbetjet, mund të thuhet se ekzistojnë mundësi të mëdha në Bashkinë Malësia Madhe për të zhvilluar dhe zbatuar skema të përshatshme për ndarjen apo mbledhjen e diferencuar të mbetjeve urbane. Për këtë qëllim skemat e mëposhtme janë analizuar në funksion të mundësive dhe pengesave të mundshme për zbatimin e tyre në zonat urbane të Bashkisë.

Përderisa nuk është një proces i thjeshtë për të filluar në një terren të panjohur, kjo na bën të ndërgjegjshëm për të nisur dhe ndërmarrë hapa të kujdesshëm në mënyrë graduale me anë të skemave pilot drejt krijimit të plotë të skemave të riciklimit dhe kompostimit në qytet.

I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes.

Sistemi parësor i ndarjes: Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre. Sistemi dytësor i ndarjes, nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre.

Në lidhje me mbledhjen e diferencuar të mbetjeve ne prozojmë skemat më poshtë sipas dy sistemeve:

a. Skema individuale – sistemi parësor

Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet thesuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga kjo pikëpamje, angazhimi i drejtpërdrejtë i pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme për biznesin dhe industrinë, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty. Ngjyrat duhet të përcaktohen qartësisht që në fillim:



Figura 17 Sistemi për ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme

Kodi i ngjyrave për katër kontenierët e vegjël nënkupton:

- Në kontenierin me ngjyrë të kuqe do të depozitohen mbetjet plastike
- Në kontenierin me ngjyrë blu do të depozitohen mbetjet si letër dhe karton

- Në kontenierin me ngjyrë të verdhë do të depozitohen kanacet metalike
- Në kontenierin me ngjyrë të gjelbërt do të depozitohen mbetje të tjera.

b. Skema e përbashkët për ndarjen e mbetjeve – Sistemi dytësor

Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë me ndryshimet e tij megjithëse eksperiencia e deritanishme në rajon apo më gjerë (Lezhë, Pogradec) nuk e rekomandon si një metodë efektive. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve.

Politika kombëtare e mbetjeve rekomandon fillimisht futjen e sistemit me tre kontenierë (kosha) për grumbullimin e mbetjeve urbane. Kjo do të përfshijë krijimin e një opsioni me tre kode ngjyrash për konsumatorët për depozitim të ndarë të mbetjeve. Konkretisht në PGM aktuale

c. Qëndrat e riciklimit – Sistemi dytësor

Zakonisht stacionet e riciklimit punojnë si plotësues për zgjidhje të tilla dhe shpesh marrin edhe pjesë të tjera të mbetjeve të bashkisë, të tilla si mbetje masive apo ato të rrezikshme si dhe mbetje të tjera të veçanta. Sa më i aksesueshëm dhe pranë zonave të banimit, të jetë stacioni i riciklimit, aq më shumë ndahen mbetjet. Kjo nxit funksionimin e skemës të grumbullimit të mbetjeve në shtëpi, skemës me telefonatë dhe në të njëjtën kohë inkurajon komunitetin dhe biznesin t'i sjellin vetë materialet e riciklueshme. Gjithsesi, kjo fazë e ndarjes mbetet ende një alternativë e parakohshme për momentin. Nismat private, të komunitetit apo (të romëve) do të nxiten edhe më tej me ngritjen e skemës parësore.

Spektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme është jashtë vëmendjes nga strukturat shtetërore. Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e manaxhimit të mbetjeve, si: i) ul mesatarisht deri 15-30 % sasinë e mbetjeve që depozitohen në lëndfill/fushë depozitimi; ii) Ul koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve; iii) Është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra; iv) Sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është i barabartë me një vend pune.




Figura 18 Hierarkia e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme

4.4.4. Proceset e Minimizimit të Mbetjeve

Politika kombëtare orienton njësitë lokale që të ofrojnë një sistem të integruar të manaxhimit të mbetjeve, ku ka vendosur edhe disa objektiva në lidhje me riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve deri në vitin 2025. Kërkesa për pakësimin e mbetjeve nuk kufizohet vetëm me përmbushjen e objektivave kombëtare, por edhe si mënyra e vetme për të zvogëluar barrën financiare të shkaktuar nga kostot e transportit dhe trajtimit final. Për më tepër, sipas PKMM-së, që nga viti 2015 njësitë e pushtetit vendor nuk do të lejohen të përdorin vend-depozitimet e tyre të pakontrolluara dhe alternativa e së ardhmes do të jetë depozitimi në landfillin rajonal. Këto kufizime për depozitimin përfundimtar do t'i shtojnë autoritetet vendore të gjejnë zgjidhje të tjera për të minimizuar barrën e mbetjeve, të tilla si riciklimi dhe kompostimi. Për më tepër, këto alternativa do të marrin mbështetje të madhe nga qeveria qendrore dhe institucionet e huaja (me mbështetje financiare dhe teknologjike). Pengesat kryesore për fillimin e riciklimit dhe kompostimit lidhen me kostot shtesë që bashkia fillimisht duhet të përballojë për të ngritur sistemin e ndarjes së mbetjeve. Ndaj, kostoja e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve do të rritet me 25-30% vetëm nga kalimi në sistemin e thjeshtë të mbledhjes së mbetjeve drejt sistemit me 2-3 kosha. Në këtë këndvështrim mund të shihet mundësia e aplikimit të skemave PPP, ku privati mund të marrë përsipër blerjen e kontenierëve që shërbejnë për këtë qëllim.

A. RICIKLIMI I MBETJEVE

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në rajonin e Shkodrës do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përzier pa ndjekur procesin e ndarjes. Për momentin, në zonë nuk ka tregje apo aktorë të interesuar për të marrë një pjesë për riciklim, përveç popullsisë rome, e cila kryen aktivitetin informal të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në venddepozitimet e mbetjeve apo në kontenierët në rrugë dhe i transportojnë vetë (me

mjetet e tyre) në qytetin e Shkodrës. Komuniteti dhe bizneset nuk janë të informuar dhe ndërgjegjësuar për proceset e ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, gjë që pengon nismat e ardhshme të riciklimit. Për më tepër, kjo do të kërkojë fonde të tjera për të mbështetur programet dhe nismat ndërgjegjëse dhe edukative për të rritur cilësinë dhe sasinë e përfshirjes së komunitetit. Baraspesha midis përfitimeve (përfshirë përfitimet ekonomike të shitjes së materialeve të ricikluara apo kostot e kursyera të depozitimit) dhe kostos së drejtpërdrejtë për ndarjen dhe transportimin e mbetjeve është një faktor thelbësor në favor apo kundër zhvillimit të këtyre veprimtarive në një shkallë më të gjerë. Po ashtu, kjo lidhet edhe me burimet e disponueshme financiare për të subvencionuar këto veprimtari.

Detyra kryesore e Bashkisë Malësia Madhe është të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme si plastikë, letër&karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun shqiptar ashtu dhe në rajon. Afrimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane të bashkisë do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe do të ulë barrën financiare të bashkisë. Përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në rajon apo jashtë kufirit shtetëror do të jetë një nga detyrat kryesore të bashkisë për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat publik-privat mbeten zgjidhjet më të mundshme për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori.

Roli i sektorit publik në sektorin e menaxhimit të mbetjeve

Politikbërës	<ul style="list-style-type: none"> •Agjensitë shtetërore •Aktorët ndërkombëtarë
Rregullator	<ul style="list-style-type: none"> •Qeveria e Shqipërisë •organizata të specializuara
Ofrues shërbimi	<ul style="list-style-type: none"> •Publik •Privat (formal, informal)
Përdorues i shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> •Banesat •Tregtar dhe institucional
Agjensitë mbështetëse	<ul style="list-style-type: none"> •Rrjete dhe OJF •institucione kerkimore dhe shkencore •Institucione financiare

Figura 19 Roli i sektorit publik në sektorin e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë këndvështrim sektori publik duhet të: i) Të përcaktojë marrëeshje të qarta institucionale; ii) Të qartësojë përgjegjësitë lidhur me këtë shërbim; iii) Fragmentizim vetëm nëpërmjet operatorit të shërbimit

dhe rregullatorit; iv) Mbatje të premtimeve politike por jo nënshtrim nga manovrat politike; v) Transparence dhe llogaridhënie.

Roli i sektorit privat në menaxhimin e mbetjeve

Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve sektori privat mund të kontribuojë në 2 forma

I. Pjesëmarrja e sektorit privat (PSP) - kontraktimi direkt i shërbimit nga kompanitë private të intresuara

II. Partneritet Publik Privat (PPP)

Madhësia e ndërmmarrjeve të krijuara në këto raste mund të jetë ndërmmarrje të vogla dhe të mesme (më së shumti informale) ose ndërmmarrje të mesme ose të mëdha (formale, kombëtare ose ndërkombëtare), të cilat mund të jenë të formën e joint venture me publikun, duke përfshirë grupe të ndryshme komunitare apo OJF. Përfshirja e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve ka shumë përparësi, pasi ofron shërbim më eficient, fleksibël për të njëjtën kosto, ka akses të lehtë në kapital (blerje makinerish/pajisje zëvendësuese etj), dhe ofron shërbim të rregullt mirëmbajtje.

Në mënyrë që përfshirja e sektorit privat në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të sa më efektive dhe të japë rezultatet e duhura në territor duhet të merren në konsideratë disa parakushte: i) Partneritet i barabartë; ii) Garë në përgjedhjen e përfaqësuesve të këtij sektori; iii) Objektiva të qarta dhe kontrata preçize me bashkinë; iv) Monitorime të vazhdueshme dhe penalitete nga ana e bashkisë për firmën kontraktore; v) Paga të rregullta për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe për të mos ulur cilësinë; vii) Përfshirje të publikut.

Disa nga mënyrat e përfshirjes të sektorit privat në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, jepen në figurën më poshtë:

Kontraktuale	<ul style="list-style-type: none"> Shërbime të kryera në bazë të një kontrate të ligjshme të lidhur nga institucioni dhe pagesa për shërbimin bëhet nga shteti
Ekskluzivitet	<ul style="list-style-type: none"> Dhënia e ekskluzivitetit ndaj një shërbimi të caktuar nëpërmjet konkurrimit të lirë në tender. Ndërmarrja fuqizohet nga pagesa direkt e komunitetit për marrjen e këtij shërbimi.
Koncesionare	<ul style="list-style-type: none"> Qeveria (pushteti vendor) ngre një koncesion për të shfrytëzuar burimet ose kryer shërbimet që janë funksion i saj.
Dhënie me qera	<ul style="list-style-type: none"> Qeveria zotëron dhe investon në pasuri dhe jep me qira përdorimin e tyre në një ndërmmarrje private. Operatori private është përgjegjës për mirëmbajtje dhe të ardhurat gjenerohen nga përfituesit e shërbimit
Garë e hapur	<ul style="list-style-type: none"> Qeveria jep një licencë dhe lirisht i lejon ndërmmarrjet private të konkurrojnë për dispozita të shërbimeve. Shpenzimet i faturohen klientit direkt nga ndërmmarrja private

Figura 20 Mënyrat e përfshirjes së sektorit privat sektorin e menaxhimit të mbetjeve

B. KOMPOSTIMI I MBETJEVE

Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se një pjesë e madhe e familjeve në bashki jetojnë në zona sub-urbane, ku ekzistojnë mundësi reale për zhvillimin e kompostimit familjar, ku një pjesë e familjeve që merren me aktivitet bujqësor dhe blektoral mund të përdorin kompostin si ushqim për kafshësh apo si pleh organik. Nisur nga fakti që 85% e familjeve në territorin e Bashkisë jetojnë në zona rurale dhe sasia e mbetjeve organike përbën rreth 52% të sasisë së mbetjeve që gjeneron bashkia, kompostimi përfaqëson një alternativë të rëndësishme trajtimi për të shmangur mbetjet nga landfilli.

Kompostimi në nivel individual (në shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve. Në rastin e mbetjeve drusore, të cilat në zonat sub-urbane janë të shumta, bashkia mund të ofrojë shërbimin e copëtimit (grirjes) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.

Metoda të tjera të kompostimit, që praktikohen në vendet e tjera të zhvilluara janë:

- Kompostimi i mbetjeve në mjedis të hapur, kompostimi në nivel komuniteti
- Kompostimi me çlirim pasiv gazi
- Kompostimi me sistem kapës të gazit
- Kompostimi i mbyllur
- Kompostimi në konteinerë.

Për rastin e Bashkisë Malësi Madhe, përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat për të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të uët që ka, mund të jetë kompostimi në mjedis të hapur. Kjo lloj metode nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetmë për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e nje sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike. Bashkia mund të inkurajojë procesin e kompostimit, duke ofruar mbështetje financiare (grante, skema bashkëfinancimi); duke miratuar politika fiskale të favorshme për kompostimin e mbetjeve; duke kategorizuar sistemin aktual të tarifave dhe duke vendosur sanksione të veçanta në rast të mos zbatimit të tyre.

Në kushte aktuale, ku Bashkia Malësi Madhe ka një territor shumë të madh në administrim, mund të fillojë të testojë procesin e kompostimit të mbetjeve organike, duke e prezantuar si një projekt pilot në një nga lagjet e bashkisë që ka më shumë potencial dhe ka interes. Ajo mund të zgjedhe të fillojë kompostimin individual ose në mjedis të hapur për të parë mundësinë e zgjerimit të skemës edhe në zona të tjera.



Figura 21 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur (majtas) dhe skemat individuale në shtëpi (djathtas)

4.4.5. Manaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (*VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”*) është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjeve inerte, ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka përcaktuar një vend për depozitimin e mbetjeve inerte⁴.

Në kuadrin ligjor theksohet se këto vend të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posacme dhe duhet të parnojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzierje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elementë të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si lëndfillet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që transporton, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj. Ndërkohë ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;

⁴ Sipas vendimit nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve” bashkitë duhet të kishin mbyllur të gjitha vend depozitimet ekzistuese jashtë çdo kushti higjeno-sanitar (brenda 2014)

- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Lendfilllet e mbetjeve inerte mund të jenë lendfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose lendfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet lendfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në lendfille dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.



Figura 22 Pamje nga hedhja e mbetjeve inerte në Bashkinë Malësia Madhe

Në kushtet kur Bashkia Malësia Madhe i depoziton mbetjet urbane ende në fushë të hapur jashtë kushteve higjieno sanitare, dhe në të shumtën e rasteve aty hidhen edhe mbetjet inerte, si fillim ajo duhet pastrojë territorin nga pikat informale të hedhjes së këtyre mbetjeve dhe njëkohësisht të nxisë ripërdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve nga sipërmarrjet private. Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzierja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

4.4.6 Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve

Sipas Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve, autoritetet vendore duhet të sigurojnë depozitimin dhe asgjësimin e sigurtë të mbetjeve urbane. Në këtë llogjikë, rekomandohet që autoritetet vendore të mbyllin vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitimin e mbetjeve në landfilllet rajonale të ardhshme apo ato ekzistuese në qarqet përkatëse. Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër ka kërkuar në mënyrë të herë pas hershme mbylljen e fushës

ekzistuese të depozitimit të mbetjeve në NJA Koplík dhe mos depozitim e mbetjeve në to pa dhënë alternativë tjetër. Kjo fushë është jashtë kushteve higjeno-sanitare dhe ndodhet mjaft pranë, pothuajse në kufi me zonën e mbrojtur të kategorisë IV (përcaktuar me VKM Nr.684 i vitit 2005, për shpalljen e rezervat natyror të Liqenit të Shkodrës dhe që përfshin dhe një pjesë të territorit të Malësisë së Madhe). Për Bashkinë Malësia Madhe, aktualisht është e pamundur që kjo fushë të mbyllet përfundimisht, për shkak të kostove shumë të larta të transportit për në lëndfillin Rajonal të Bushatit. Megjithatë për Bashkinë Malësia Madhe, depozitimi final i mbetjeve për në lëndfillin Rajonal të Bushatit do të jetë alternativa në të ardhmen. Plani merr në analizë tre alternativa në lidhje me depozitim dhe trajtimin final të mbetjeve:

- a) **Përdorimi i fushës ekzistuese afër Përroit të Thatë në NJA Koplík:** Në terma afat shkurtër dhe afat mesëm, Bashkia Malësia Madhe është e detyruar të përdorë këtë vend depozitim për depozitim e mbetjeve nga NJA Koplík, Kastrat, Shkrel, Gruemirë dhe Qendër (përfshihet për terma afat shkurtër njësia Kelmend, për shkak të kostove të larta të transportit). Në mënyrë të tillë që bashkia të ketë mundësi që të përdorë këtë fushë për një periudhë të shkurtër kohore, në një mënyrë sa më të moderuar, ajo duhet të marrë disa masa për fushën ekzistuese. Si fillim kjo fushë duhet të rrethohet për të mos lejuar hyrjen e pakontrolluar të kafshëve apo largimin e mbetjeve nga era, si dhe vendosja e një roje, i cili duhet të sigurojë që mbetjet që depozitohen në këtë fushë vijnë vetëm ngë Bashkia Malësia Madhe dhe nuk janë mbetje të rrezikshme. Gjithashtu bashkia mund të alokojë fonde që të përdoret dhe, ose mbetje inerte për të mbuluar herë pas herë mbetjet të cilat depozitohen në fushë. Kjo praktikë, si dhe presimi i mbetjeve sa herë që depozitohen do të rrisë jetëgjatësinë e fushës.
- b) **Stacioni i transferimit:** Stacionet e transferimit janë alternativa efektive për të ulur koston e transportit të mbetjeve, kur vendi final i depozitimit të mbetjeve është larg dhe rrit në mënyrë duke rritur në mënyrë të ndjeshme koston. Në të njëjtën kohë, ndërtimi i një stacioni transferimi do të shërbente gjithë zonës së Malësisë Madhe për të zgjidhur çështjen depozitimit dhe trajtimit final të mbetjeve. Si fillim mbetjet nga të gjitha njësitë e bashkisë do të transportohen për në stacionin e transferimit dhe më pas ato do të mund të transportohen për në lëndfillin rajonal të Bushatit. Kjo mënyrë e ndërmjetme e trajtimit të mbetjeve do të shërbejë, së pari për një tranzitim të mbetjeve urbane për në impiantin rajonal (duke ulur ndjeshëm koston e transportit), dhe së dyti mund të shërbejë si qendër për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme, mbetjeve voluminoze apo mbetjeve të tjera dhe më pas transferimin e tyre në impiante për përpunim.

Ndërtimi dhe funksionimi i Stacioneve të transferimit mund të jenë një mundësi e mirë për aplikimin e skemave PPP. Bashkia Malësia Madhe mund të ftojë palët e intresuara, duke marrë në konsideratë sasinë e mbetjeve të gjeneruara (ditore/vjetore) si edhe përbërjen e tyre, duke shkurtuar distancën e transportit të mbetjeve dhe reduktimin e emetimeve nga djegia e karburantit në masën 20-50%.

Në rastin e ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve mund të shqyrtojmë dy alternativa:


- A. Dërgimin e të gjitha mbetjeve të përziera të depozituara në stacionin e transferimit direkt në lëndfillin e Bushatit. Në këtë rast bashkia do të duhej të blinte të ri ose të përdorur (ose merrte me qera) një kamion me kapacitet mbajtës 20 Ton me vlerë të përafërt **12,510,000** Lek. Kjo makinë do të bënte 1 rrugë në ditë (20 ton/ditë).

B. Minimizimin e mbetjeve në burim , dergimin e tyre ne stacionin e transferimit të mbetjeve dhe më pas në lëndfillin e Bushatit.

Kostot operacionale te stacionit te transferimit				
	Skenari pa minimizim mbetjesh ne burim		Skenari me minimizim mbetjesh ne burim	
VITI	Kosto operacionale e ST (lek/vit)	Lek/ton (Te gjitha mbetjet)	Kosto operacionale e ST (lek/vit)	Lek/ton (riciklim)
2017	6,989,823.0	984.0	6,889,575.0	1,010.0
2018	6,996,519.0	981.0	6,703,375.0	1,067.0
2019	7,006,556.0	979.0	6,515,445.0	1,135.0
2020	7,016,593.0	976.0	6,326,476.0	1,218.0
2021	7,026,284.0	974.0	6,135,777.0	1,321.0

Tabela 19 Llogaritjet e mundshme për stacionin e transferimit

Krahasoni i kostove operacionale për Stacionin e transferimit të mbetjeve:



PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

Stacion Transferimi			
Kapaciteti perpunues ST =	7,600	ton/vit	
kapaciteti perpunues ne jave	146		
Dite pune ne vit	365	dite	7 dite/jave
Ngarkesa ditore per transferim	21	ton/dite	
Distanca per ne depozitimin final	36	km	
Shpejtesia mesatare e levizjes	50	km/h	
Koha e transportit per nje rruge	1.4	ore	
Koha per ngarkim dhe shkarkim	1.5	ore	0.75 h ngarkim 0.75 h shkarkim
Koha e punes per nje rruge	2.9		
Rruge ne turn	2.7		
Turne ne dite	1		
Kapaciteti i trajlerit	20	ton	Trajleri mban 2 x10t
Kapaciteti i nje trajleri ne turn	20	tone	kontenitore
Kapaciteti i nje trajleri ne dite			
Nr. trajlerave per turn	1		
Nr. i trajlerave qe duhen	1		
Kosto kapitale e kamionit	90,000	€	
Kosto kapitale per trajlerin	12,510,000	Leke	
O&M costs			
Punetore			3,600,000
Mirembajtja dhe sigurimi i trajlerit			503,640
Karburant dhe lubrifikant			2,154,600
Shofer			294,000
Shpenzime administrative	9%	operative	265,702
Kosto e plote operacionale			7,158,839

		Kosto kapitale	Kosto operacionale		Komente	
		Euro	Leke	Euro/ ton		Leke/ ton
Stacion transferimi	unit	30,000	4,200,000	6.7	943	Sistem i thjeshte; pa kompaktim; Kosto varet nga madhesia e ST
Kamion (trajler) i perdorur-50m ³	unit	50,000	7,000,000			
Kosto		80,000	11,200,000	-	7,166,800	
Kosto e analizuar (perdorim per 10 vjet)		8,000	1,120,000			
Kosto njesi	Leke/ton	1.05	147.4	6.70	943	1,090.4
Kosto e plote e tranzimit						
	banore	kg/ban/dite	ton/vit	Kosto operative	Kosto kapitale	Kosto totale
Bashkia Malesi e Madhe	39,266		7,600	7,166,800	1,120,000	8,286,800

Tabela 20 Kostot e operimit të stacionit të transferimit

C. Një proces ndarjesh mbetjesh në burim, duke larguar fillimisht 5 % të mbetjeve të riciklueshme që vijnë në stacion me një trend rritës 45% deri në vitin e pestë, si edhe kompostimin në masën deri në 5 % për vitin e parë dhe deri në 45 % për vitin e 5-të.

Sasia e mbetjeve e parashikuar për t'u gjeneruar në 5 vitet e ardhshme në bashkinë e Malësia Madhe.

Viti		2015	2016	2017	2018	2019	2020
Projeksioni i rritjes së popullsisë (0.34%)	nr.	38,358	38,488	38,619	38,751	38,882	39,015
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton)	% sipas rrymave	7,341	7,366	7,391	7,417	7,442	7,467
Organike	52%	3,818	3,831	3,844	3,857	3,870	3,883
Letër+Karton	10%	734	737	739	742	744	747
Plastike	11%	808	810	813	816	819	821
Qelq	5%	367	368	370	371	372	373
Tekstil	5%	367	368	370	371	372	373
Hekur	1%	73	74	74	74	74	75
Inerte	7%	514	516	517	519	521	523
Sanitare	3%	220	221	222	222	223	224
Të tjera	6%	440	442	443	445	447	448

Tabela 21 Projeksioni i rritjes së popullsisë dhe rrymave të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme

Viti		2015	2016	2017	2018	2019	2020
Projeksioni i rritjes së popullsisë (0.34%)	nr.	38,358	38,488	38,619	38,751	38,882	39,015
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton) pa riciklim	% sipas rrymave	7,341	7,366	7,391	7,417	7,442	7,467
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton) me riciklim		7,341	7,366	7,099	6,831	6,560	6,287
%e riciklimit në vit			0%	5%	10%	15%	20%
Organike	52%	3,818	3,831	3,844	3,857	3,870	3,883
Organike për depozitim			3,831	3,651	3,471	3,289	3,106
Letër+Karton	10%	734	737	739	742	744	747
Letër+Karton për depozitim			737	702	667	633	597
Plastike	11%	808	810	813	816	819	821
Plastike për depozitim			810	772	734	696	657
Qelq	5%	367	368	370	371	372	373
Qelq për depozitim			368	351	334	316	299
Tekstil	5%	367	368	370	371	372	373
Alumin	1%	73	74	74	74	74	75
Alumin për depozitim			74	70	67	63	60
Inerte	7%	514	516	517	519	521	523
Sanitare	3%	220	221	222	222	223	224
Të tjera	6%	440	442	443	445	447	448

Tabela 22 Projeksioni i rritjes së popullsisë dhe rrymave të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme duke aplikuar riciklimin

Grafikisht jepet sasia e mbetjeve e planifikuar për riciklim:




Figura 23 Sasia e mbetjeve që parashikohet të riciklohet gjatë 5 viteve të ardhshme

4.4.7 Kostot e minimizimit të mbetjeve në burim

Minimizimi i mbetjeve në burim kërkon një sërë investimesh në teknologji si edhe paraprakisht nisjen e një fushate ndërgjegjësimi të mbështetur në programe apo strategji konkrete për të ardhmen. Ky proces kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis bashkisë Malësi e Madhe dhe të komunitetit apo grupeve të tjera të interesit të lidhura direkt ose indirekt me këtë proces. Siç është përmendur dhe më lart skemat e minimizimit të mbetjeve janë një mundësi e mirë për aplikimin e partneritetit publik privat (PPP) apo gjenerimit të të ardhurave për vetë bashkinë e Malësisë së Madhe. Duke konsideruar sasinë e mbetjeve të riciklueshme, gjykohet se për këtë proces nevojitet vendosja e kontenerëve për ndarjen e mbetjeve në burim pranë PGM publike, pranë institucioneve, bizneseve të ndryshme apo kudo që gjykohet nga sektori i shërbimeve i Bashkisë. Në rastin e kompostimit të mbetjeve (kryesisht për pjesët rurale të kësaj bashkie), ky proces mund të bëhet individualisht nga banorët e zonës dhe aty ku bashkia apo palë të tjera të interesuara mund të financojnë blerjen apo ndërtimin e strukturave të posaçme për kompostimin e mbetjeve.

Kostot për minimizimin e mbetjeve jepen si më poshtë:

Kostot per minimizimin e mbetjeve Zona 1							
Viti	Popullsia e sherbyer	Norma ditore e gjenerimit te mbetjeve te riciklueshme (kg/banor/dite)	Kosto totale operionale(lek/vit)	Kosto e menaxhimit te mbetjeve (lek/vit)	Konteinere per riciklim (cope)	Norma ditore e gjenerimit te mbetjeve organike (kg/banor/dite)	Struktura per kompostim (cope)
2017	24,873	0.00764	3,082,264	3,482,959	14	0.0145	12
2018	24,973	0.02302	3,235,526	3,656,145	44	0.0437	35
2019	25,073	0.03851	3,386,024	3,826,207	72	0.0731	59
2020	25,173	0.05412	3,547,727	4,008,932	103	0.1027	83
2021	25,273	0.06986	4,501,108	5,086,252	103	0.1326	107

Kostot per minimizimin e mbetjeve Zona 2					
Viti	Popullsia e sherbyer	Norma ditore e gjenerimit te mbetjeve te riciklueshme (kg/banor/dite)	Kosto totale operacionale kompostim (lek/vit)	Kosto e menaxhimit te mbetjeve (lek/vit)	Struktura per kompostim (cope)
2017	13,638	0.0101	0	0	4
2018	13,692	0.0304	0	0	13
2019	13,747	0.0509	0	0	22
2020	13,802	0.0717	0	0	31
2021	13,858	0.0926	0	0	40

Tabela 23 Kosto për minimizimin e mbetjeve për të dy zonat (sipas Skenarit 2)

SKENARI 3

Alternativa rajonale – landfilli i Bushatit: Alternativa tjetër për depozitimin e mbetjeve është landfilli i Bushatit, që është rreth 36 km nga qendra e NJA Kopluk. Ky landfill është ndërtuar sipas kuadrit ligjor shqiptar dhe standardeve teknike për një landfill modern, të parashikuar në direktivat e BE-së (EC 1999/31/EC). Ai është projektuar për t'u përdorur për rreth 20 vitet e ardhshme me një kapacitet prej 47,000 ton/vit, duke e kthyer një alternative mëse të përshtatshme afatgjatë për të gjithë rajonin e Shkodrës.

Pengesa kryesore e kësaj alternative është distanca e madhe e transportit 36 km nga venddepozitimi aktual i mbetjeve, e cila rrit koston e transportit duke ndikuar direkt në rritjen e kostos operacionale.

- a. Rasti i transportit direkt në landfillin e Bushatit pa minimizim mbetjesh në burim. Në këtë rast kosto operacionale do të jetë përkatësisht :
- Për Zonën 1 kosto operacionale do të jetë 11,504,250 Lek/vit, Kosto e menaxhimit të mbetjeve 12,999,808 Lek/vit
 - Për Zonën 2 kjo kosto do të jetë 11,296,170 Lek/vit, Kosto e menaxhimit të mbetjeve 12,764,672 Lek/vit

Në total llogaritet në rritje prej 32 % koston operacionale për zonën 1 dhe 30% të rritjes së kësaj kostoje për zonën 2 vetëm prej rritjes së distancës së shtuar të transportit prej 36km. Ndërkohë nëse në shtojmë edhe koston e tarifës hyrëse në landfillin e Bushatit (3 euro/ton), bashkisë Malësia Madhe vetëm kosto e depozitimit të mbetjeve në landfill, për një sasi vjetore prej 7,341 ton/mbetje/vit, do të ishte 22,023 euro/vit ($22,023 \times 137 \text{ lek/euro} = 3,017,151 \text{ lek/vit}$).

- b. Në rastin e minimizimit të mbetjeve në burim, dërgimin e tyre në Stacionit e Transferimit të mbetjeve dhe më pas transporti i tyre në landfillin e Bushatit. Kostot për Skenarin 3 do të jenë:

SKENARI 3 me Stacion Transferimi dhe depozitim final ne landfillin e Bushatit				
Viti	Kosto operacionale (lek vit)	Kosto e menaxhimit te mbetjeve (Lek/vit)	Kosto (lek/ton)	Kosto (lek/banor)
2017	25,160,538.25	28,236,433.00	3,548.48	653.33
2018	21,768,170.25	24,408,324.00	3,057.10	562.99
2019	21,693,340.95	24,329,088.00	3,033.81	558.82
2020	21,628,314.16	24,260,956.00	3,012.08	554.92
2021	19,501,298.07	21,862,824.00	2,704.56	498.35

Tabela 24 Kosto me stacion transferimi dhe depozitim ne landfillin e Bushatit për të dy zonat (Skenari 3)


SKENARI 4

Minimizim i mbetjeve në burim dhe transporti dhe depozitimi i tyre direkt në landfillin e Bushatit. Ky skenar nga ana mjedisore është shumë i përshtatshëm sepse mundëson mbylljen e fushës egzistuese të depozitimit të mbetjeve në mënyrë përfundimtare, duke larguar në këtë mënyrë një hot-spot nga territori i Malësisë së Madhe. Distanca e largët (36km) me landfillin e Bushatit, si edhe tarifa e depozitimit të mbetjeve në këtë landfill sjell rritjen e kostos operacionale për këtë skenar. Kostot për skenarin 4 jepen si më poshtë:

SKENARI 4 Skenari me minimizim mbetjesh dhe transport direkt ne landfillin e Bushatit				
Viti	Kosto operacionale (lek vit)	Kosto e menaxhimit te mbetjeve (Lek/vit)	Kosto (lek/ton)	Kosto (lek/banor)
2017	28,655,785.00	32,381,038.00	4,041.42	840.82
2018	23,900,056.00	27,008,065.00	3,356.50	698.51
2019	23,813,210.00	26,908,926.00	3,330.28	693.17
2020	23,736,235.00	26,821,946.00	3,305.64	688.18
2021	20,080,576.00	22,691,051.00	2,784.90	579.87

Tabela 25 Kosto me minimizim mbetjesh dhe transport ne landfillin e Bushatit – Skenari 4

Duke konsideruar tarifën e depozitimit të mbetjeve si një faktor të rritjes së kostos operacionale rekomandohet që procesi i minimizimit të mbetjeve të fillojë brenda vitit 2017. Grafiku si më poshtë jep ndryshimin e koston së depozitimit të mbetjeve në funksion të sasisë totale të mbetjeve dhe asaj të minimizuar.



SKENARI 5

Minimizim i mbetjeve në burim depozitimi i tyre direkt në vendin aktual të depozitimit të mbetjeve pa ndërtuar Stacion transferimi të mbetjeve. Ky skenar nga ana financiare është i përshtatshëm, por nga ana mjedisore është jo i përshtatshëm pasi zona ku depozitohen mbetjet do të jetë gjithmonë në presionin e ndotjes dhe problematikave të tjera që shoqërojnë këtë depozitim mbetjesh aty.

SKENARI 5 (me modifikim levizje), minimizim mbetjesh dhe depozitim ne venddepozitimin aktual				
Viti	Kosto operacionale (lek vit)	Kosto e menaxhimit te mbetjeve (Lek/vit)	Kosto (lek/ton)	Kosto (lek/banor)
2017	18,891,025.00	21,346,858.00	2,769.33	477.88
2018	15,668,099.00	17,704,949.00	2,493.45	395.00
2019	15,764,286.00	17,813,643.00	2,745.68	396.08
2020	15,871,221.00	17,934,480.00	3,055.20	397.42
2021	13,917,741.00	15,727,047.00	2,997.13	347.33

Tabela 26 Kosto me minimizim mbetjesh dhe depozitim ne venddepozitimin aktual – Skenari 5

KRAHASIMI I SKENARËVE

- SKENARI 1: (pa modifikim lëvizje), depozitim në venddepozitimin aktual
- SKENARI 2: (me modifikim lëvizje) depozitim në venddepozitimin aktual
- SKENARI 3: Stacion Transferimi dhe depozitim final në lëndfillin e Bushatit
- SKENARI 4: Minimizim mbetjesh dhe transport direkt në lëndfillin e Bushatit
- SKENARI 5: Minimizim mbetjesh dhe depozitim në venddepozitimin aktual

Krahasimi i skenarëve do të bëhet duke krahasuar kostot operacionale, kostot për ton mbetje dhe kostot per banor për secilin skenar. Të specifikuar këto parametra jepen:





Figura 24 Krahasimi i kostove të skenarëve





Figura 25 Krahasimi i kostove njësi të skenarëve

4.4.8. Mbetjet jo-urbane

Mbetjet spitalore (të kujdesit shëndetësor)

Autoritetet urbane duhet të monitorojnë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), menaxhimin e mbetjeve spitalore dhe të parandalojnë përzierjen e tyre me mbetjet urbane. Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Bashkia nuk mund të përfshijë largimin e mbetjeve spitalore në shërbimin e saj të menaxhimit të mbetjeve. Rregullore Nr.6 dt.30.11.2007; “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

përcakton qartë detyrimet e prodhueseve të mbetjeve spitalore dhe fazat e kryerjes së këtij procesi deri në asgjësimin e tyre.

Mbetjet elektrike dhe elektronike (MEE)

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një Vendim (VKM.Nr. 957, datë 19.12.2012 **Për mbetjet nga pajisjet Elektrike dhe elektronike**” ku përcaktohen disa rregulla lidhur me menaxhimin e këtyre mbetjeve.

Në Kreun IX të këtij vendimi, pika 5 përcaktohet se njësitë e qeverisjes vendore duhet të llogarisin peshën totale të hyrjeve dhe daljeve në territorin e tyre dhe përqindjet përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim gjatë vitit kalendarik paraardhës dhe duhet t’i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim. **Në Kreun XI të këtij vendimi, pika 5 përcaktohet:** Prodhuesit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, duhet të marrin masat e nevojshme që konsumatorët të marrin pjesë në grumbullimin e diferencuar të MPEE-ve dhe duhet t’i nxitin ata të lehtësojnë procesin e ripërdorimit, trajtimit dhe rikuperimit. Në këtë kontekst, bashkia e Malësisë së Madhe duhet të ndërtojë qendra për grumbullimin e diferencuar të MEE që gjenerohen nga familjet dhe të pengojë depozitimin e tyre në landfill. Njëkohësisht, duhet t’i kërkojë zotëruesve të MEE të respektojnë rregullat lokale dhe VKM e lartpërmendur për grumbullimin e tyre dhe të monitorojnë zbatimin e tyre.

Mbetjet nga vajrat e përdorur⁵

Është e rëndësishme të kryhet grumbullimi i këtyre mbetjeve, me qëllim shmangien e ndotjes në mjedisit, dhe në të njëjtën kohë të përfitohet nga riciklimi dhe përdorimi i kësaj lënde. Për këtë qëllim, industria, konsumatorët dhe garazhet e automjeteve duhet të përfshihen në iniciativat e grumbullimit të kësaj lënde, duke mos i derdhur, por duke i dorëzuar ato pranë grumbulluesve të autorizuar. Krijimi i skemave publike-private për grumbullimin, depozitimin dhe riciklimin e këtyre mbetjeve, duhet të shoqërohet me një sërë sanksionesh lokale administrative për derdhjen pa kriter të tyre.

Mbetjet nga gomat e përdorura

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi sasinë e mbetjeve nga gomat e përdorura që gjenerohet në Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe nuk ekzistojnë aktivitete formale të grumbullimit të tyre në nivel lokal. Inspektimi i aktiviteteve private të paligjshme të grumbullimit dhe tregtimit të gomave të përdorura, regjistrimi, mbledhja e të dhënave mbi sasinë e këtyre mbetjeve si dhe parandalimi i përdorimit të tyre për djegie të pakontrolluar, mbeten detyrat parësore të autoriteteve lokale.

Në monitorimet për përgatitjen e këtij plani në zonën e Malësisë Madhe u konstatua një rast, kur gomat digjeshin në mënyre të pakontrolluar duke shkaktuar ndotje masive. Duke qënë që ato kanë një vlerë kalorifike të lartë, këto mbetje paraqesin një produkt me vlerë energjitime për të ushqyer dhe furnizuar impiantet e ardhshme të trajtimit energjetik të mbetjeve (nëse do ndërtohen një i tillë në rajon apo në vend).

⁵ Aktualisht Qeveria Shqiptare ka miratuar një VKM.765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”

4.5. Treguesit e performancës

Cilësia dhe sasia e shërbimeve lidhen me përbushjen e standardeve të cilësisë dhe sasisë të tilla si:

- Niveli i standardizimit dhe numri i kazanëve, pikat e grumbullimit dhe pikat e hapura, makinat, etj.;
- Rregullsia e mbledhjes së mbetjeve, numri i kazanëve jo të tejmbushur apo PGM jo të mbingarkuara;
- Pastërtia e pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- Sipërfaqe rrugë të pastruara;
- Shtimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- Numri i veprimtarive të reja të lidhura me ndarjen e mbetjeve në burim;
- Iniciativa për kompostimin e mbetjeve;
- Iniciativa për riciklimin e mbetjeve.

Treguesit për efikasitetin e shërbimit:

- Person-orë (apo person-ditë) për mbledhjen e mbetjeve, pastrimin e rrugëve
- Person-ditë për banorë;
- Koha e përdorimit për automjetet

Treguesit për kënaqjen e konsumatorëve:

- Përbushja e pritshmërive të konsumatorit;
- Pjesëmarrja aktive në nismat vendore për ndërgjegjësimin dhe pakësimin e mbetjeve

Kënaqësia e konsumatorëve (komunitetit dhe bizneseve) është një indikator i rëndësishëm për të vlerësuar performacën e bashkisë në lidhje me administrimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, anketimet e propozuara në vazhdim duhet të krahasohen me anketime paraardhëse (nesë ka pasur të tilla) dhe me ato në vazhdim.

KLASIFIKIMI PER INDIKATORET E MATJES SE PERFORMANCES		klasifikimi i koduar sipas ngjyrave				
		I ulet	Mesatarisht I ulet	I mesem	Mesatarisht i lartë	I lartë
INDIKATORËT E CILËSISË SË SHËRBIMIT	C1 Eficenca në grumbullimin e mbetjeve	0-49%	58.52%	70-89%	90-98%	99-100%
	C2 efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve	0-20%	21-40%	50.00%	61-80%	81-100%
	C3 Eficenca në adresimin e ankesave të klientëve	0-40%	41-50%	51-70%	71-90%	99-100%
INDIKATORET E QENDRUESHMERISË MJEDISORE	D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve	0.13%	6-10%	11-20%	21-30%	>30%
	D2 Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin	22.99%	50-74%	75-84%	85-94%	95-100%
	D3 Shkalla e mbrojtjes së mjedisit në trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve	20%	21-40%	14-60%	61-80%	81-100%
INDIKATORET E QENDRUESHMERISË EKONOMIKO-FINANCIARE	E1 shkalla e rikuperimit të kostos	10.30%	41-60%	61-75%	75-85%	85-100%
	E2 Eficenca në mbledhjen e tarifave		43.95%			
INDIKATORËT E ASPEKTEVE INSTITUCIONALE	F1 Vlerësimi i përshatshmërisë së politikave kombëtare të MMN përfshirë zbatimin e tyre	0-20%	21-40%	45.00%	61-80%	81-100%
	F2 Shkalla e koherencës së institucioneve lokale	0-20%	21-40%	60.00%	61-80%	81-100%

Tabela 27 Performanca e Bashkisë

4.6 Skenarët e administrimit të mbetjeve

Skenari 1: Administrimi i zakonshëm i mbetjeve

Ky skenar bazohet në përfaqshjen e zakonshme të organizimit të shërbimeve të mbetjeve duke filluar nga grumbullimi i mbetjeve nga pikat e përbashkëta apo publike dhe transporti i tyre për në vend depozitimin përkatës, në rastin konkret në vend depozitimin e NJA Koplík, dhe në NJA Kelmend. Sistemi bazohet në përdorimin e pikave të përbashkëta për grumbullimin e mbetjeve të përbërë nga kontenierë 1.1m³, ku mbetjet do të hidhen të përziera. Në të gjithë territorin e bashkisë propozohet që mbulimi me PGM të përbashkëta të bëhet, duke vendosur vetëm kontenierë 1.1 m³. Bashkia mund të propozojë që brenda kësaj skeme të vendosë në territor edhe kontenierë 1.1m³ me ngjyrë për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme. Në kushtet e grumbullimit të përzier të mbetjeve, ato do të grumbullohen në sajë të kalendarit javor të vendosur nga bashkia dhe do të depozitohen, në terma afat shkurtër, në vend depozitimin e NJA Koplík dhe në atë të NJA Kelmend.




Figura 27 “Skema e manaxhimit të mbetjeve – Skenari 1”

Siç mund ta shohim edhe nga skema, në këtë skenar propozohet ndërtimi i një stacioni transferimi, i cili do të eliminojë të gjitha vend depozitimet e tjera të mbetjeve, me perspektivën që më pas mbetjet të depozitohen në landfillin rajonal të Bushatit, pasi janë transferuar në ST nga të gjitha NJA të bashkisë.

Zbatueshmëria: Kjo skemë është vazhdim i skemës aktuale të mbledhjes së mbetjeve. Ai gjen zbatim për momentin dhe rezultati mund të jetë mjaft i kënaqshëm në një nivel optimal të largimit të mbetjeve, duke bërë një mbulim shumë të mirë të zonës me kontenierë, ku rreth 90% e popullsisë të ketë akses tek këto pika.

Efektiviteti (cilësia): Për sa i përket efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit, ky skenar në kushtet e reja të planifikimit të shërbimit (financimit, mjetet, riorganizimi i lëvizshmërisë) mundëson një përmirësim të dukshëm duke e krahasuar me gjëndjen aktuale. Sidoqoftë është e nevojshme në këtë skenar të bëhet një informim i publikut lidhur me frekuencën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve,

reduktimin në burim të mbetjeve, pagesën e tarifës së pastrimit apo çështje të tjera që lidhen me këtë shërbim.

Performanca e pakësimit të mbetjeve: Në lidhje me pakësimin e mbetjeve dhe perspektivës së saj për përmbushjen e objektivave vendorë, ky skenar duket më pak i preferuar dhe më pak efektiv për sa kohë që ai mbështet vetëm në sistemin e pikave të hapura me dy kosha, i cili ka rezultuar jo shumë efektiv në ndarjen e mbetjeve, sidomos kur mungon kultura qytetare për ndarjen e mbetjeve.

Aspektet sociale: Ky sistem kërkon qëndrim pasiv të banorëve dhe bizneseve, ndaj ai nuk inkurajon pjesëmarrjen e tyre. Ai nuk ofron shërbim të barabartë, ku disa zona mbulohen me shërbim më të shpeshtë me një numër të caktuar PGM, ndërsa të tjerat kanë një rrjet më të vogël PGM, ku në disa raste (NJA Kelmend, Shkrel) konsumatorët duhet të kryejnë distanca të largëta për të hedhur mbetjet në pikën më të afërt.

Si përfundim, ky skenar përfaqëson një mënyrë praktike dhe me kosto të ulët dhe shoqërisht të pranueshme për përmirësimin e situatës aktuale në ofrimin e një mjedisi urban më të pastër, por nuk ofron kushtet optimale për zhvillimin e skemave efektive të minimizimit të mbetjeve.

Skenari 2: Administrimi i Kombinuar i Mbetjeve

Në thelb, ky skenar i administrimit të mbetjeve bazohet në sistemin e mbledhjes individuale në burim mbi të cilat janë hartuar skemat e ndarjes dhe mbledhjes së mbetjeve të riciklueshme. Ky skenar parashikon ndryshimin gradual nga sistemi aktual i mbledhjes drejt atij të personalizuar (individual). Duke iu referuar përbërjes merceologjike të mbetjeve si edhe duke konsideruar objektivat që parashikon strategjia kombëtare e mbetjeve dhe Ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” mund të ndërmerren disa hapa në ndarjen e mbetjeve në burim. Kjo gjë duhet të bëhet në bashkëpunim me operatorë të intresuar për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, por mund të bëhet edhe nga vetë bashkia me ndërmarrjen e saj, duke filluar si fillim fushata ndërgjegjësuese me komunitetin dhe me projekte pilot.

Për këtë rekomandohet që ky proces të fillojë në zonat me dëndësi të lartë (aty ku shërbimi kryhet 7 herë/jave), në PGM pranë institucioneve apo pranë bizneseve si edhe në çdo subjekt që shpreh dëshirën për të bashkëpunuar në këtë aspekt.

Zbatueshmëria dhe cilësia e shërbimeve: Zbatimi i sistemit individual duket më pak praktik dhe më shumë i ndërlikuar, për sa kohë kërkon pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Për sa i përket cilësisë së shërbimeve, nëse banorët dhe bizneset bien dakord të marrin pjesë aktivisht në këtë skemë individuale të mbledhjes së mbetjeve, kjo me siguri do të zgjidhë shumë probleme me situatën aktuale të administrimit të mbetjeve. Për më tepër, kjo do të bënte të mundur heqjen e PGM-ve të mbetjeve nga rrugët dhe hapësirat publike dhe do të çonte në përmirësimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve. Ky skenar duhet të vihet në zbatim pas aplikimit të tij në një zonë pilot për të parë sjelljen e banorëve apo subjekteve aty, përpara sesa bashkia të marrë iniciativën për ta aplikuar në të gjithë territorin e saj. Kjo do të kërkojë, si fillim zgjedhjen e një zone të mirë pilotimi dhe aplikimin e disa masave nxitëse, si tarifim të reduktuar për konsumatorët që do t'i ndajnë mbetjet në burim. Një zonë e mirë pilot mund të jetë një zonë me përqëndrim të lartë të familjeve të përjashtuar nga tarifa e pastrimit apo atyre që jetojnë me përkrahje sociale, të cilët në këtë mënyrë mund të nxiten edhe drejt puneve të industrisë së riciklimit.

Performanca e minimizimit të mbetjeve: Kjo ofron një perspektivë të mirë për ngritjen e një sistemi të efektshëm dhe cilësor për ndarjen në burim të mbetjeve, gjë që do të çonte në rritjen e riciklimit dhe kompostimit në të ardhmen dhe do të siguronte respektimin e plotë të objektivave kombëtarë dhe vendorë për pakësimin e mbetjeve.




Figura 28 “Skema e administrimit të mbetjeve – Skenari 2”

Si përfundim, skenari i kombinuar i administrimit të mbetjeve paraqet një sistem të përmirësuar që është i përqendruar në performancën e përgjithshme të shërbimit për sa i përket cilësisë dhe pakësimin të mbetjeve, por duket mjaft i ndjeshëm dhe i varur nga shkalla e përfshirjes së publikut. Ai kërkon aftësi dhe mjeshtri të manaxhimit të mirë nga autoritetet vendore për të vepruar me efektivitet dhe efikasitet për uljen e kostove.

5. PERSPEKTIVA FINANCIARE

5.1. Financimi dhe strategjia e “mbulimit të kostos”

5.1.1 Llogaritja e kostove të dy skenarëve të administrimit të mbetjeve

Nga analizimi i skenarëve janë përzgjedhur si më të përshtatshëm nga kënvështrimi i kostos operacionale Skenari 3 dhe Skenari 5.

Skenari 3: Mbetjet do të grumbullohen në PGM publike (me minimizim në burim fillimisht në 5% të sasisë totale të mbetjeve të riciklueshme të tyre, e cila në vitin e pestë do të shkojë në 20%) dhe me pas do të depozitohen në ST dhe me vonë **në lëndfill**.

Skenari 5: Mbetjet do të grumbullohen në PGM publike (me minimizim 5% të sasisë totale të mbetjeve të riciklueshme të tyre, e cila në vitin e pestë do të shkojë në 20%) dhe depozitimi final të bëhet në fushën aktuale te depozitimit të mbetjeve.

Një kontribues i rëndësishëm në rritjen e kostos operacionale është edhe aplikimi i transportit nga Stacioni i Tranferimit deri në Lëndfill. Megjithatë ky transport është më eficient, duke e krahasuar me transportin direkt të mjeteve direkt nga zona e grumbullimit për në lëndfillin e Bushatit (krahasimi i Skenarëve 3 dhe 4. Praktikrat ndërkombëtare sygjerojnë studimin e fizibilitetit në rastet kur lëndfillet janë mbi 30 km nga zona e grumbullimit të mbetjeve.

Për të parë mundësinë e përgjdhjes midis skenarëve është e nevojshme përlllogaritja e investimeve që nevojiten për të bërë të realizuar skenarët e menaxhimit të mbetjeve. Këto investime përfshijnë pjesët teknologjike të procesit (*makina, kontenierë të llojeve të ndryshëm për zbatimin e skemave te riciklimit apo kompostimit dhe grumbullimit si në pikat publike ashtu edhe grumbullimin individual*) dhe infrastrukturën (*mbyllja e fushës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve, ndërtimi i Stacionit të Transferimit të mbetjeve etj*).

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e planit të investimeve të propozuar për periudhën 2017-2021:

PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

Skenari 3					
Viti	Lloji i investimit	Sasia (cope)	cmim/njesi (lek)	vlera totale(lek)	investimet (lek) Skenari 3
2017	Kompatator 10 ton	1	5,977,000	5,977,000	24,710,000
	Kompatator 20 ton	1	12,510,000	12,510,000	
	Makine transporti per materiale te riciklueshme	1	3,588,000	3,588,000	
	Mbyllja e fushes ekzistuese te depozitimit të mbetjeve	1	per tu llogaritur	per tu llogaritur	
	konteinere 1.1	59	35,000	2,065,000	
	konteinere 1.1 Riciklim	14	35,000	490,000	
	kosha per kompostim	16	5,000	80,000	
2018	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,210,000
	konteinere 1.1 Riciklim	30	35,000	1,050,000	
	kosha per kompostim	32	5,000	160,000	
2019	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,225,000
	konteinere 1.1 Riciklim	28	35,000	980,000	
	kosha per kompostim	49	5,000	245,000	
2020	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,410,000
	konteinere 1.1 Riciklim	31	35,000	1,085,000	
	kosha per kompostim	65	5,000	325,000	
2021	konteinere 1.1	0	35,000	0	410,000
	konteinere 1.1 Riciklim	0	35,000	0	
	kosha per kompostim	82	5,000	410,000	
Total					28,965,000

Tabela 28 Investimet kapitale për skenarin 3

PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

Skenari 5					
Viti	Lloji i investimit	Sasia (cope)	cmim/njesi (lek)	vlera totale(lek)	investimet (lek) Skenari 5
2017	Kompatator 10 ton	1	5,977,000	5,977,000	28,910,353
	Kompatator 20 ton	1	12,510,000	12,510,000	
	Makine transporti per materiale te riciklueshme	1	3,588,000	3,588,000	
	Mbyllja e fushes ekzistuese te depozitimit të mbetjeve	1	per tu llogaritur	per tu llogaritur	
	Stacion transferimi	1	4,200,000	4,200,000	
	konteinere 1.1	59	35,000	2,065,000	
	konteinere 1.1 Riciklim	14	35,000	490,000	
	kosha per kompostim	16	5,000	80,353	
2018	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,210,000
	konteinere 1.1 Riciklim	30	35,000	1,050,000	
	kosha per kompostim	32	5,000	160,000	
2019	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,225,000
	konteinere 1.1 Riciklim	28	35,000	980,000	
	kosha per kompostim	49	5,000	245,000	
2020	konteinere 1.1	0	35,000	0	1,410,000
	konteinere 1.1 Riciklim	31	35,000	1,085,000	
	kosha per kompostim	65	5,000	325,000	
2021	konteinere 1.1	0	35,000	0	410,000
	konteinere 1.1 Riciklim	0	35,000	0	
	kosha per kompostim	82	5,000	410,000	
Total					31,940,353

Tabela 29 Investimet kapitale për skenarin 5

Kostot njësi (lek/ton) dhe (lek/banor) për skenarët 3 dhe 5 janë përkatësisht:





Figura 29 Krahasimi kostove dhe investimeve sipas dy skenarëve

Rekomandime për investime

Pronësia mbi investimet: Sipas analizës së nevojave për investime, zbatimi i të dy skenarëve të administrimit të mbetjeve kërkon blerjen e kompatatorit me kapacitet 10 ton, makinës transportuese të mbetjeve nga Stacioni i Transferimit në lendfill, makinës për grumbullim dhe transportin e materialeve të riciklueshme, kontenierë të rinj për të plotësuar nevojat dhe për të përmirësuar performancën e shërbimeve dhe zbatimin e skemes të ndarjes së mbetjeve (kosha me ngjyra) dhe të kompostimit familjar. Në kushtet e administrimit të ri të bashkisë Malësi Madhe, ku akoma nuk ka disa paqartësi në ndarjen e

buxhetit për vitin ardhshëm në lidhje me shërbimet e mbetjeve, bashkia, me qëllimin final përmirësimin e performancës të shërbimeve të mbetjeve, mund të nisë planin për zbatimin e këtyre investimeve gjithmonë duke përzgjedhur variantin më të përshtatshëm për kushtet financiare dhe fizike që ajo ka. Është e rëndësishme që këto investime të nisin me gjërat parësore të përcaktuara në këtë strategji, si blerja e kontenerëve për mbulimin në shkallën më të lartë të territorit të bashkisë apo mbylljen e fushës ekzistuese të mbetjeve dhe ndërtimin e Stacionit të Transferimit të mbetjeve po në territorin ku aktualisht është kjo fushë depozitimi. Aktualisht Bashkia ka parashikura blerjen e 100 kontenerëve të rinj me fondet e saj dhe blerjen e një mjetit teknologjik 10ton si një bashkë financim i bashkisë me fondet e projektit dldp, Helvetas Sëiss Intercooperation. Ndërkohë si pjesë e projektit të hartimit të planit është parashikuar që për bashkinë Malësia e Madhe të hartohet edhe një plan para fizibiliteti për të vlerësuar qëndrueshmërinë e ndërtimit të stacionit të transferimit. Në kushtet ku bashkia e ka të pamundur për të financuar këto investime kapitale, ajo mund të kërkojë financime nga qeveri shqiptare ose të vlerësojë dhënie të këtij shërbimi tek kontraktorët privatë ose të aplikojë skemë PPP lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Në rastin e SKENARIT 3 do të kemi këtë strukturë dhe fond total vjetor për ndërmarrjen publike:

Kosto administrative Ndermarrje		
	Administrata e ndermarrjes	Pagat Totale & perfitimet(lek/vit)
1	Administrator	924,000Lek
2	sekretar	360,000Lek
3	Pergj sektori	600,000Lek
4	Inspektori	312,000Lek
5	Jurist	600,000Lek
6	Financier	576,000Lek
7	Shofer (3)	493,560Lek
8	Punëtor transporti (5)	745,000Lek
9	Pastruese zyrash	300,000Lek
10	Kosto administrative	303,480Lek
	Total	5,214,040Lek
	Fondi total per ndermarrje (lek/vit)	5,214,040Lek

Tabela 30 Kostot administrative për Skenarin 3

Në rastin e SKENARIT 5 do të kemi këtë strukturë dhe fond total vjetor për ndërmarrjen publike:

Kosto administrative Ndermarrje		
	Administrata e ndermarrjes	Pagat Totale & perfitimet(lek/vit)
1	Administrator	924,000Lek
2	sekretar	360,000Lek
3	Pergj sektori	600,000Lek
4	Inspektori	312,000Lek
5	Jurist	600,000Lek
6	Financier	576,000Lek
7	Shofer (2)	338,040Lek
8	punetor transporti (4)	601,000Lek
9	Pastruese zyrash	300,000Lek
10	Kosto administrative	303,480Lek
	Total	4,914,520Lek
	Fondi total per ndermarrje (lek/vit)	4,914,520Lek

Tabela 31 Kostot administrative për Skenarin 5

Ngritja e një ndërmarrje publike do të jete problematike nesë nuk sigurohen fondet e nevojshme për blerjen e teknologjisë. Po kështu kjo kompani publike do të shtonte shpenzimet operacionale dhe kostot administrative. Një staf punonjësish do të duheshin trainuar dhe përgatitur për funksione të tilla si Administrator i ndërmarrjes, ekonomist, përgjegjës turni, etj. Të gjithë këto shpenzime do të shtonin nivelin e tarifimit të shërbimit të pastrimit, me 15-20% çdo vit. Gjithësesi kjo do të varet nga vetë bashkia e Malësisë së Madhe për t'ia referuar më vonë këshillit bashkiak.

5.1.2. Strategjia e mbulimit të koston dhe niveli i tarifave

Sipas legjislacionit ekzistues, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në principet e mëposhtme:

- Parimin “kush ndot paguan”
- Rakordimin me buxhetin vjetor
- Prioritetet lokale dhe politike
- Mundësia e pagesës
- Kufizimet ligjore (p.sh., niveli i tarifave për biznesin e vogël)

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të menaxhimit të mbetjeve në Bashki tregon se ajo ka arritur një performancë **mesatare** në realizimin e të ardhurave për menaxhimin e mbetjeve, por buxheti aktual është **i pamjaftueshëm** për modernizimin e shërbimeve të pastrimit dhe përmbushjen e standarteve kombëtare për një menaxhim mjedisor të mbetjeve.

Baza e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit aktual të tarifave dhe të të ardhurave nga mbetjet duhet të mbështet në parimin “ndotësi paguan” apo mbi “përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve” si dhe në

elasticitetin e sistemit në mbështetje të iniciativave për minimizimin e mbetjeve. Qëllimi i bashkisë është të zbatojë sistemin e mbulimit të plotë të kostos të ofrimit të shërbimit. Fillimisht ajo duhet të rrisë nivelin grumbullimit të tarifave të pastrimit, duke u fokusuar sidomos në prodhuesit e mëdhenj të mbetjeve siç janë bizneset, institucionet etj. Me arritjen e këtij objekti, plani rekomandon rritjen e nivelit të tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, koston së mirëmbajtjes dhe amortizimit si dhe duke përdorur subvencione apo të ardhura të tjera të bashkisë për të mbështetur kostot administrative.

Ndarja e kostove sipas normës së prodhimit të mbetjeve

Parimi “ndotësi paguan” nënkupton që prodhuesit e mbetjeve duhet të paguajnë koston e plotë të administrimit të mbetjeve të tyre. Duke marrë parasysh këtë parim, kostoja duhet të ndahet në përputhje me prodhimin e mbetjeve për konsumatorët dhe të mbulohet nga vetë konsumatorët. Ndërsa zbatimi i principit që konsumatori paguan për çfarë përfiton apo sa mbetje gjeneron, mund të kërkojë nivele të larta të tarifave për familjet, dhe një investim në infrastrukturë dhe kohë nga ana e bashkisë për ta realizuar këtë gjë, e cila mund të sjellë stepje nga të dyja palët. Për të minimizuar këtë problem, rekomandohet që bashkia të subvencionojë pjesën kapitale dhe administrative të shpenzimeve për konsumatorët familjarë duke iu alokuar atyre vetëm koston operative të shërbimeve të pastrimit. Prandaj, duke marrë në konsideratë përcaktimet dhe rekomandimet e mësipërme, kostoja totale për shërbimet e pastrimit dhe mbledhjes së mbetjeve ndahet mes konsumatorëve familjarë, bizneseve dhe institucioneve. Referuar të dhënave të marra nga administrata e bashkisë kemi arritur të gjenerojmë shkallën e gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të prodhuesit të tyre, e cila na mundësoi ndarjen e kostove në bazë të prodhimit të mbetjeve:

Kontribuesit te gjenerimi i mbetjeve sipas kategorive							Perqindja mesatare e kontribuesve te gjenerimit te mbetjeve sipas kategorive (Zona1)	Perqindja mesatare e kontribuesve te gjenerimit te mbetjeve sipas kategorive (Zona2)
NJA	ton/vit	Banore(%)	Biznesi i madh(%)	Biznesi i vogel(%)	Institucione(%)	total		
NJA Koplik	2,276.96	0.66	0.05	0.29	0.01	1.00	0.78	0.91
NJA Gruemire	1,901.35	0.87	0.03	0.07	0.03	1.00	0.04	0.02
NJA Qender	727.05	0.91	0.02	0.05	0.02	1.00		
NJA Shkrel	607.57	0.91	0.02	0.03	0.04	1.00	0.16	0.04
NJA Kastrat	1,335.07	0.81	0.05	0.12	0.03	1.00		
NJA Kelmend	584.96	0.90	0.03	0.04	0.04	1.00	0.02	0.03

Tabela 32 Të dhënat mbi shkallën e gjenerimit të mbetjeve sipas konsumatorëve

Nisur nga fakti që bashkia do të ketë frekuencë dhe kosto të ndryshme shërbimi, në procesin e tarifimit duhet të grupohen sipas kësaj dy ndarjeve në zona që kemi prezantuar më lart: zona 1 (Koplik, Gruemirë, Kastrat) dhe zona 2 (Qendër, Shkrel dhe Kelmend). Në këtë mënyrë plani do të japë një pasqyrim më të qartë mbi tarifimin e subjekteve të ndryshëm prodhues të mbetjeve në dy zonat përkatëse. Tarifimi për skenarët e përzgjedhur do të ndahet sipas zonave dhe duke analizuar situatën e shkallës së pagesës duke nisur me 40%, 70% dhe 100%:

PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

ZONA 1(pagesa e tarifës ne masen 40%)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	3,367.18	2,420.52	3,331.48	2,432.83	3,295.14	2,446.81	3,258.08	2,463.06	2,766.89	2,029.42
Biznes i vogel	7,469.41	5,369.43	7,419.92	5,418.43	7,368.37	5,471.40	7,314.55	5,529.70	6,236.48	4,574.25
Biznes i madh	24,988.25	17,962.94	24,822.67	18,126.88	24,650.23	18,304.08	24,470.18	18,499.13	20,863.60	15,302.76
Institucione	9,015.81	6,481.06	8,956.07	6,540.21	8,893.85	6,604.15	8,828.89	6,674.52	7,527.63	5,521.27
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	15,180,717.86	10,912,741.00	15,080,126.12	11,012,339.00	14,975,365.47	4,644,299.00	14,865,983.69	11,238,481.00	12,674,932.59	9,296,646.00

ZONA 1(pagesa e tarifës ne masen 70%)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	2,735.84	1,966.67	2,706.83	1,976.67	2,677.30	1,988.03	2,647.19	2,001.24	2,248.09	1,648.90
Biznes i vogel	6,068.90	4,362.66	6,028.68	4,402.48	5,986.80	4,445.51	5,943.07	4,492.88	5,067.14	3,716.58
Biznes i madh	20,302.96	14,594.89	20,168.42	14,728.09	20,028.31	14,872.06	19,882.03	15,030.54	16,951.68	12,433.50
Institucione	7,325.35	5,265.86	7,276.81	5,313.92	7,226.25	5,365.87	7,173.47	5,423.05	6,116.20	4,486.03
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	15,180,717.86	10,912,741.00	15,080,126.12	11,012,339.00	14,975,365.47	4,644,299.00	14,865,983.69	11,238,481.00	12,674,932.59	9,296,646.00

ZONA 1(pagesa e tarifës ne masen 100%)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	2,104.49	1,512.82	2,082.17	1,520.52	2,059.46	1,529.26	2,036.30	1,539.41	1,729.30	1,268.39
Biznes i vogel	4,668.38	3,355.89	4,637.45	3,386.52	4,605.23	3,419.62	4,571.59	3,456.06	3,897.80	2,858.91
Biznes i madh	15,617.66	11,226.84	15,514.17	11,329.30	15,406.40	11,440.05	15,293.87	11,561.95	13,039.75	9,564.23
Institucione	5,634.88	4,050.66	5,597.54	4,087.63	5,558.66	4,127.59	5,518.06	4,171.58	4,704.77	3,450.79
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	15,180,717.86	10,912,741.00	15,080,126.12	11,012,339.00	14,975,365.47	4,644,299.00	14,865,983.69	11,238,481.00	12,674,932.59	9,296,646.00

Tabela 33 Tarifa e pastrimit për zonën 1 (Koplik, Gruemirë, Kastrat)

ZONA 2 (nese tarifa do te paguhet ne masen 40%)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	4,037.33	3,227.61	2,938.07	1,876.05	2,931.54	1,863.95	2,930.79	1,851.90	2,937.61	1,839.78
Biznes i vogel	9,422.66	7,532.86	6,884.28	4,395.83	6,896.57	4,385.01	6,922.39	4,374.10	6,966.65	4,363.10
Biznes i madh	102,475.09	81,922.86	74,869.24	47,806.42	75,002.91	47,688.73	75,283.72	47,570.04	75,765.01	47,450.47
Institucione	71,238.33	56,950.89	52,047.38	33,233.92	52,140.30	33,152.11	52,335.52	33,069.60	52,670.10	32,986.48
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	9,979,820.39	7,978,284.00	7,291,347.88	4,655,760.00	7,304,365.53	4,644,299.00	7,331,713.31	4,632,740.00	7,378,585.41	4,621,095.00

ZONA 2 (nese tarifa do te paguhet ne masen 70%)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	3,280.33	2,622.43	2,387.18	1,524.29	2,381.88	1,514.46	2,381.27	1,504.67	2,386.81	1,494.82
Biznes i vogel	7,655.91	6,120.45	5,593.48	3,571.61	5,603.46	3,562.82	5,624.44	3,553.95	5,660.40	3,545.02
Biznes i madh	83,261.01	66,562.32	60,831.26	38,842.71	60,939.86	38,747.09	61,168.02	38,650.66	61,559.07	38,553.50
Institucione	57,881.15	46,272.60	42,288.49	27,002.56	42,363.99	26,936.09	42,522.61	26,869.05	42,794.46	26,801.51
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	9,979,820.39	7,978,284.00	7,291,347.88	4,655,760.00	7,304,365.53	4,644,299.00	7,331,713.31	4,632,740.00	7,378,585.41	4,621,095.00

PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

ZONA 2 (nese tarifa do te paguhet ne masen 100 %)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	2,523.33	2,017.25	1,836.30	1,172.53	1,832.21	1,164.97	1,831.74	1,157.44	1,836.00	1,149.86
Biznes i vogel	5,889.16	4,708.04	4,302.67	2,747.40	4,310.36	2,740.63	4,326.49	2,733.81	4,354.15	2,726.94
Biznes i madh	64,046.93	51,201.79	46,793.27	29,879.01	46,876.82	29,805.46	47,052.33	29,731.28	47,353.13	29,656.54
Institucione	44,523.96	35,594.31	32,529.61	20,771.20	32,587.69	20,720.07	32,709.70	20,668.50	32,918.81	20,616.55
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	9,979,820.39	7,978,284.00	7,291,347.88	4,655,760.00	7,304,365.53	4,644,299.00	7,331,713.31	4,632,740.00	7,378,585.41	4,621,095.00

Tabela 34 Tarifa e pastrimit për zonën 2 (Qendër, Kelmend, Shkrel)

Tarifimi ne rastin kur do të integrohet nje ndërmarrje per menaxhimin e mbetjeve në varësi të Bashkisë Malësi e Madhe (për të dy zonat).

ZONA 1(Me ndermarrje publike dhe 70% te tarifes se paguar)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	3,097.25	2,307.32	3,066.79	2,315.96	3,035.83	2,325.96	3,004.29	2,337.82	2,603.78	1,984.16
Biznes i vogel	6,870.61	5,118.32	6,830.39	5,158.13	6,788.51	5,201.17	6,744.78	5,248.54	5,868.85	4,472.24
Biznes i madh	22,985.01	17,122.88	22,850.48	17,256.08	22,710.37	17,400.05	22,564.08	17,558.53	19,633.73	14,961.48
Institucione	8,293.04	6,177.97	8,244.50	6,226.03	8,193.95	6,277.97	8,141.16	6,335.15	7,083.89	5,398.13
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	17,787,737.86	13,370,001.00	17,687,146.12	13,469,599.00	17,582,385.47	7,101,559.00	17,473,003.69	13,695,741.00	15,281,952.59	11,753,906.00

ZONA 2(Me ndermarrje publike dhe 70% te tarifes se paguar)										
Subjekt/vit	2017		2018		2019		2020		2021	
	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5	Skenari 3	Skenari 5
	Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit		Tarifa Lek/vit	
Familjare	3,939.50	3,243.73	3,043.75	2,143.15	3,035.82	2,130.83	3,032.60	2,118.59	3,035.51	2,106.26
Biznes i vogel	9,194.33	7,570.50	7,131.90	5,021.66	7,141.88	5,012.87	7,162.86	5,004.00	7,198.82	4,995.07
Biznes i madh	99,991.94	82,332.14	77,562.18	54,612.53	77,670.79	54,516.91	77,898.95	54,420.48	78,290.00	54,323.32
Institucione	69,512.10	57,235.42	53,919.45	37,965.38	53,994.95	37,898.91	54,153.56	37,831.87	54,425.41	37,764.33
Total te ardhura te parashikuara(Lek/vit)	12,586,840.39	10,435,544.00	9,898,367.88	7,113,020.00	9,911,385.53	7,101,559.00	9,938,733.31	7,090,000.00	9,985,605.41	7,078,355.00

Tabela 35 Tarifa e pastrimit për zonën 1 dhe 2 kur kemi një ndërmarrje publike




Figura 30 Tarifatat sipas skenareve Zona 1




Figura 31 Tarifatat sipas skenareve Zona 2

Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve

Për të mundësuar një parashikim dhe strategji reale të llogaritjes së të ardhurave për periudhën 5-vjeçare, rekomandohet që bashkia të marrë në konsideratë faktorë të tjerë socialë (si psh. pamundësia e disa familjeve për të paguar), apo eksperiencat dhe performancat aktuale të bashkisë për të mbledhur të ardhurat (që lidhet me nivelin aktual të pagesës së tarifave nga konsumatorët si dhe performancën aktuale të bashkisë për mbledhjen e të ardhurave). Identifikimi dhe vlerësimi i këtyre faktorëve do të ndihmojnë

bashkinë të orientojë veprimet dhe strategjitë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të mbetjeve. Për të vlerësuar efektivitetin e sistemit drejt arritjes së objektivave të mbulimit të kostos, të ardhurat e planifikuara për secilin konsumator përmbledhen së bashku dhe krahasohen me koston totale operative kapitale. Në rastin tonë, përqindjet e mbulimit të kostos për vitet në vazhdim paraqiten e larta dhe në progres drejt mbulimit të plotë në vitin 2021, nëse analiza nuk i kthehet rivlerësimit të nivelit të tarifave apo nëse politika vendore nuk subvencionon tarifën. Çdo vit, bashkia duhet të shqyrtojë strategjinë e mbulimit të kostos dhe rritjen e tarifave bazuar në analizën e propozuar dhe duhet të marrë parasysh edhe performancën në vjeljen e tarifave, sondazhin mbi vullnetin për të paguar, kostot dhe synimet, si dhe të propozojë ndryshime në paketën fiskale.

Faturimi dhe vjelja e tarifave

Në vijim të praktikës së deritanishme, tarifën e mbetjeve do të kenë formën e një detyrimi të drejtpërdrejt që vjen si faturë më vete tek konsumatori. Bashkia, gjithashtu mund të shikojë si alternativë bashkimin e këtij detyrimi me detyrime të tjera lokale (elektriciteti, uji, apo shërbime të tjera publike) nëse praktika aktuale nuk performon siç duhet.

Forma e faturimit dhe procedura e vjeljes mund të jenë të ndryshme për çdo lloj konsumatori, si njësi tregtare, familje apo institucion. Rekomandohet që mënyra e pagesës të ofrojë mundësi të ndryshme për sa i përket ndarjes së detyrimit në 2-3 pjesë/herë në vit (për bizneset kryesisht) përveç alternativës një herë në vit. Bashkia mund të vazhdojë të mbledhë vetë tarifën me anë të procedurës normale, duke autorizuar inspektorët e bashkisë të administrojnë dhe detyrojnë pagimin e tarifave për konsumatorët, siç ka bërë deri tani ose t'ia kalojë përgjegjësinë e vjeljes së tarifave një agjenti të jashtëm publik ose privat vetëm nëse modeli aktual nuk performon siç duhet.

Rekomandime

Në funksion të këtij plani, analiza e kostos vjetore u mbështet në metodologjinë e përcaktuar nga DLDP , ku shpenzimet kapitale regjistrohen dhe vlerësohen përgjatë jetëgjatësisë së përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve (makinat teknologjike dhe kontenerët). Kjo përjasje rekomandohet të përdoret nga bashkia kur të vlerësojë buxhetin vjetor për administrimin e mbetjeve.

Të shqyrtohet strategjia e tarifave: çdo vit, bashkia duhet të shqyrtojë strategjinë e mbulimit të kostos dhe të rrisë tarifën sipas analizës së propozuar dhe të marrë parasysh performancën e vjeljes së tarifave, vullnetin për të paguar, kostot dhe objektivat si dhe të propozojë ndryshime në paketën fiskale.

Bashkia duhet të kujdeset të llogarisë kapacitetin e vërtetë të konsumatorëve për të paguar tarifën, me qëllim që të subvencionojë skemën e administrimit të mbetjeve për të mbuluar hendekun e të ardhurave nga konsumatorët që nuk kanë mundësi të paguajnë (familjet me asistencë sociale apo me pak të ardhura). Ky lloj grupimi mund të përfshihet i pari në skemat e minimizimit të mbetjeve ku gjatë këtij procesi mund të vlerësohet edhe krijimi i “green job” në funksion të skenarëve të propozuara nga ky plan.

Incentiva për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Bashkia duhet të aplikojë tarifa më të ulëta për konsumatorët që përfshihen në programet pilot të minimizimit të mbetjeve. Kjo do të ndihmojë

në ndryshimin e qëndrimit të konsumatorëve me rezultatin përfundimtar pakësimin e sasisë së mbetjeve që ata prodhojnë.

Transparenca dhe komunikimi: Proçesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira. Informacioni për shërbimin duhet t'i shpjegohet banorëve se sa kushton aktualisht administrimi i mbetjeve të ngurta. Bashkia duhet të realizojë një fushatë të fortë ndërgjegjësimit për të gjithë banorët, veçanërisht për banorët duke reklamuar shërbimin e mbledhjes së mbetjeve, rregullave dhe përgjegjësive.

Detyrimi për të paguar tarifën: Bashkia duhet të miratojë dhe përdorë të paktën një nga mekanizmat e mëposhtme për të detyruar banorët që nuk paguajnë për shërbimet e ofruara të mbetjeve, të tilla si: (i) sanksione të drejtpërdrejta në rast mospagese apo kamat vonesa për pagesat e prapambetura; (ii) lidhjen e pagesës së tarifës së mbetjeve me ndonjë tarifë vendore apo kombëtare të detyrueshme (p.sh., fatura e energjisë elektrike, taksë mbi pronës, etj.).

6. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

6.1. Rregullorja vendore

Bashkia e Malësisë Madhe duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

- a. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
- b. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
- c. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
- d. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegjen e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
- e. Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitim të kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme;
- f. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- g. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulate të shitjes;
- h. Marrjen e masave për sigurimin e një pasterie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;
- i. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit
- j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve)
 - Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
 - Proçedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
 - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
 - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
 - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
 - Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
 - Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
 - Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

6.2 Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të

merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për shkurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

6.3 Licencimi mjedisor

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me ARM (Agjencia Rajonale e Mjedisit) kur japim miratime për njerëz që ushtrojnë veprimtari apo projekt për administrimin e mbetjeve;
- Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme);
- Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.

6.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e manaxhimit të mbetjeve:

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- Skemat e minimizimit të mbetjeve që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkupimim PPP;
- Administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të bashkisë;
- Dukë qënë që është i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncension e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve (përfshirë edhe Stacionin e Transferimit të Mbetjeve), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbetjeve të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

Tabela 36 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta

Ofrimi i kamionëve apo makinerive të rënda – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve	Fshirja apo pastrimi i rrugëve dhe zonave të hapura – me kontratë shërbimi
Mbledhja e mbetjeve të përgjithshme urbane nga të gjitha lagjet / i gjithë qyteti – me kontratë shërbimi	Riparimi i makinerive të bashkisë për mbetjet urbane – me kontratë shërbimi sipas nevojave apo me kontratë afatgjatë
Ofrimi i kontenerëve të posacëm për skemat e minimizimit të mbetjeve	Operimi i ST – me kontratë shërbimi ose koncesion
Mbledhja e mbetjeve komerciale nga hotelet, zyrat, tregjet apo dyqanet	Vjelja e tarifave të përdoruesit apo taksave të mbetjeve – me të drejtë ekskluzive për mbledhjen e tarifave me agjentë, si ndërmarrja e ujësjellësit, apo elektriku.

6.5 Mbështetja politike

Manaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia e qytetit duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për qytetin dhe banorët e tij dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori, përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, dhe nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe publikut për të gjitha veprimet që ajo ndërmerr. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit. Mbetet detyrë e stafit të Bashkisë që këtë çështje t’ia argumentojë dhe adresojë në mënyrë sa më profesionale Këshillit Bashkiak me qëllim marrjen e dakordësisë në miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve si dhe buxhetin përkatës për zbatimin e tij.

7. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në qytet, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme riciklimi bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të mbledhjes, dukezbatuar kërkesat të hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrjedhën e mbetjeve të mbledhura. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektiv për arritjen e objektivit. Kjo mund të arrihet duke hartuar një plan ndërgjegjësimi i cili do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së qytetit dhe koston së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; iii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda per komunikim dhe informim

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesit në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të koston së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i komparatorëve apo makinave të tjera që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenierët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) një slogan domethënës për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

Marrja e opinioneve të qytetarëve

Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t’i japë bashkisë mendime apo opinione ose komente për shërbimin e mbetjeve?

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

- Mundësia e publikut për t'u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”: Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, del nevoja për të komunikuar me përfituesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifat. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet në periodikisht nga bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

8. Plan Veprimi

8.1. Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional

1	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
1.1	Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar	1.1.0 Miratimi i Planit Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve Urbane	Bashkia Malësia Madhe ; Këshilli i Bashkisë	2016
		1.1.1 Përditësimi i Rregullores Lokale të Manaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik) Konsulentë të jashtëm & Ekspertë; Këshilli Bashkiak	2016
		1.1.2 Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penaliteteve për çështjet e mbetjeve	Bashkia Malësia Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e manaxhimit financiar) Këshilli i Bashkiak	2016
		1.1.3 Përdorimi i mjeteve adekuate për komunikimin dhe informimin e publikut rreth rregullave dhe penaliteteve (<i>shih mjetet e informimit</i>)	Bashkia Malësia Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve), Vullnetarët, OJQ, përfaqësues të komunitetit,	2016-2017
1.2	Parandalimi i rrezikut nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislacionit shqiptar;	1.2.1 Informimi i komunitetit për të diferencuar mbetjet e rrezikshme nga mbetjet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mbetjeve	Bashkia Malësia Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2016 - 2021
		1.2.2 Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndare të mbetjeve të rrezikshme (<i>të ngjashme me skemat e redukimit të mbetjeve</i>)	Bashkia Malësia Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve); ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2017
		1.2.3 Ruajtja e sigurtë në mënyrë të përkohshme e mbetjeve të rrezikshme (sipas rregullores për administrimin e tyre) derisa të sigurohet një zgjidhje rajonale apo kombëtare për trajtimin përfundimtar të tyre.	Bashkia Malësia Madhe , (Drejt. Shërbimeve publike) ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2016-2017
1.3	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve inerte dhe ndërtime	1.3.1 Inspektimi i përbashkët me Agjensinë Rajonale të Mjedisit, (ARM) Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik, etj për gjenerimin, grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore.	Bashkia Malësia Madhe , Përgjegjësi i Shërbimeve & Inspektorët bashkiakë); ARM	2016-2021
		1.3.2 Këto subjekte duhet të gjenerojnë të ndara këto mbetje nga mbetjet e tjera urbane dhe të kujdesen për asgjësimin e tyre në përputhje me standartet kombëtare (rregullorja kombëtare për asgjësimin e tyre)	Bashkia Malësi e Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve, Policia Urbane apo Inspektorët bashkiakë) Qendra Mjekësore Malësi Madhe, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik	2016

1.4	Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe ndërkufitar për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij;	1.3.3	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre	Bashkia Malësi e Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë); Kompanitë e ndërtimit	2016-2021
		1.3.4	Projektim dhe ndërtim ose miratim të një vendepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëlimore brenda standarteve kombëtare.	Bashkia Malësi e Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkisë	2017
		1.3.6	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve	Bashkia Malësi e Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve); Industria e ndërtimit	2016-2021
		1.4.1	Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet	Bashkia Malësi e Madhe ; Keshilli I Bashkise	2017
		1.4.2	Vendosja e gjobave dhe penaliteteve ndaj personave fizike dhe juridike që shkelin rregullat e vendosura në rregulloren lokale të manaxhimit të mbetjeve	Bashkia Malësi e Madhe , (Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiak);	2017
		1.4.3	Përmirësimi i procedurave të licencimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjensisë Rajonale të Mjedisit (ARM)	Bashkia Malësi e Madhe ; ARM	2017
		1.4.5	Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimit e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve	Bashkia Malësi e Madhe ; Qarku i Shkodrës, si dhe njësitë e tjera lokale	2016

8.2. Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve

2	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
2.1	Përmirësimi i shërbimeve të pastrimit në qytetin e Malësi e Madheut; Ofrimi i shërbimeve eficiente dhe cilësore;	2.1.1 Rinovimi i infrastrukturës aktuale të grumbullimit të mbetjeve - dhe blerja e kontenierëve të rinj shtesë.	Bashkia Malësia Madhe; (Përgjegjës shërbimesh, Dep. për Manaxhimin dhe Hartimin e Programeve Financiare-DMHPF);	2016
		Zëvendësimi i pikave të hapura prej betoni për grumbullimin e mbetjeve në një sistem të standardizuar me kontenierë me rrota si dhe riorganizimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve sipas distancave të rekomanduara në këtë plan	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjësi i shërbimeve, DMHPF);	2016-2017
		2.1.2 Ngritja e sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim, zbatimimi në zona të ndryshme pilot (sipas skemës së propozuar në këtë plan)	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjës shërbimesh, DMHPF); NGO	2017
		2.1.3 Krijimi i skemave individuale (në burim) pilot të grumbullimit për konsumatorët e mëdhenj	Bashkia Malësia Madhe (biznese të mëdhenj, NGO)	2017
		2.1.4		
		Hartimi i marrëveshjeve efektive me konsumatorët e mëdhenj (p.sh. Hotelet, bizneset), për të specifikuar qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e palëve në një shërbim të diferencuar;	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjës i shërbimeve, Bizneset të mëdhenj)	2017
		2.1.5 Përmirësimi i produktivitetit të fuqisë punëtore: trajnimi i stafit,	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjësi i shërbimeve, DMHPF);	2016-2017
Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit (shih mjetet e informimit) të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj;	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegjësi i shërbimeve); NGO, Grupet e komunitetit, etj	2017-2019		

8.3. Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve

3	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
---	----------------------	----------------------	-------------------------------------	---------------

3.1	Mbyllja e fushës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve dhe gjetja e zgjidhjeve mjedisore dhe ekonomike në zbatim të politikës kombëtare dhe rajonale në depozitimin e mbetjeve;	3.1.1	Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimit lokal.	Bashkia Malësia Madhe , Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2016-2017
		3.1.2	Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit;	Bashkia Malësia Madhe & Ekspertë, Konsulentë të jashtëm; Kompani private	2016-2017
		3.1.3	Rehabilitimi i venddepozitimit lokal (sipas projektit)	Bashkia Malësia Madhe , MTI; Këshilli Bashkiak, Donatorë	2018-2019
		3.1.4	Hartimi dhe miratimi I një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes.	Bashkia Malësia Madhe & Këshilli Bashkiak	2017-2018
		3.1.5	Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (MTI) për financimin e projektit të landfillit të ri ndër-vendor	Bashkia Malësia Madhe & Këshilli Bashkiak, Donatorë, NGO, etj	2017-2018
		3.1.6	Gjetja e mundësive alternative me NGO, Projekte, Donatorë për financimin e projektit të landfillit të ri ndër-vendor	Bashkia Malësia Madhe & Këshilli Bashkiak, Donatorë, NGO, etj	2018
		3.1.7	Gjetja e zgjidhjeve financiare për të mbuluar koston e rritur të depozitimit në landfillin e Bushatit, nëse bëhet subvencionim nga qeveria qendrore	Bashkia Malësia Madhe & Këshilli Bashkiak, Qeveria Qendrore	2020

8.4. Komponenti: Ndarja dhe Riciklimi i mbetjeve

4	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e jerë	Afate t kohore	
4.1	Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot; Progresi drejt	4.1.1	Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara	Bashkia Malësia Madhe , NGO, Komuniteti, vullnetarë,	2016- 2017
		4.1.2	Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbetjeve, i cili duhet të koordinohet me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbetjeve të tjera urbane	Bashkia Malësia Madhe , (Përgjegjësi i shërbimeve, ekspertë të jashtëm	2016-2017
		4.1.3	Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit të shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan	Bashkia Malësia Madhe , Ekspertë& Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2017
		4.1.4	Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit.	Bashkia Malësia Madhe , Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2016- 2021

PLMMNU - BASHKIA MALËSIA E MADHE

4.2	objektivave kombëtarë për minimimin e mbetjeve në nivel lokal.	4.1.5	Organizimi i takimeve me grupet e interesit ne rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive	2016- 2020
			Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektivitetit dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbajtja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relatimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki;	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit	2016-2020
		4.1.6	Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve.	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë, bizneset e mëdhenj të qytetit, konsumatorët e skemave pilot	2016-2017
		4.1.7	Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm;	2017
		4.2.1	Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2017
		4.2.2	Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materialet e riciklueshme	Bashkia Malësia Madhe, Ekspertë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2017-2020
	Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit				

8.5. Komponenti: Aspektet Financiare

5	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
5.1	Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave; Krijimi një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investimet e nevojshme)	5.1.1 Aplikimi çdo vit i metodologjisë së "Llogaritjes së plotë të kostos sipas modelit të DLDP " kur shpenzimet kapitale vlerësohen dhe llogaritet përgjatë gjithë jetës së dobishme të makinave dhe kontenerëve	Bashkia Malësia Madhe (Përgje, Shërbimesh, dhe Dep. për Manaxhimin dhe Hartimin e Programeve Financiare-DMHPF)	2017-2021
5.1.2		Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe kostos kapitale	Bashkia Malësia Madhe (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2017-2021
5.1.3		Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficent të tarifave	Bashkia Malësia Madhe (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2017
5.1.4		Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka	Bashkia Malësia Madhe , Këshilli Bashkiak	2017-2020
5.1.5		Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total	Bashkia Malësi e Madhe (Policia Urbane, Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2017-2018
5.1.7		Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve	Bashkia Malësia Madhe (Policia Urbane, Insp. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2017-2021
5.1.8		Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifata e heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit.	Bashkia Malësia Madhe (Përgjegj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2018
5.1.9		Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan" dhe përcaktimet e bëra në këtë plan	Bashkia Malësia Madhe (Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2017-2019
5.1.10		Kryerja e studimeve periodike (vjetore) mbi "Dëshirën për të paguar" dhe "Mundësinë për të paguar" nga qytetarët;	Bashkia Malësia Madhe (Dep.MHPF, Përgj. Shërbimeve), OJQ-të, Vullnetarë	2017-2020
5.1.11		Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektivave si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan	Bashkia Malësia Madhe (Dep.MHPF, Insp. Shërbimeve) Ekspertë të jashtëm	2017-2019
5.1.12	Transparenca dhe komunikimi: Proçesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë"	Bashkia Malësia Madhe (Dep.MHPF, Përgj Shërbimeve), OJQ-të, Vullnetarë, OJQ	2016-2019	

8.6 Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi

6	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afate t kohore	
6.1	Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të qytetit si dhe për aplikimin e skemave inovative për mbetjetve;	6.1.1	Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj	Bashkia Malësia Madhe; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2016-2021
		6.1.2	Ofrimi i informacioneve specifik për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot)	Bashkia Malësia Madhe; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2013-2015
		6.1.3	Lançimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta;	Bashkia Malësia Madhe; Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2011-2015
		6.1.4	Krijimi i grupeve në komunitet për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin në zonat pilot dhe konsumatorët pilot	Bashkia Malësia Madhe; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2017
		6.1.5	Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit sipas grupeve të interesit (qytetarët, bizneset, shkollat, industria, etj)	Bashkia Malësia Madhe; Komuniteti, Bizneset e riciklimit, OJQ-të, Donatorë	2017-2019
		6.1.6	Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenerët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit)	Bashkia Malësia Madhe;	2017
		6.1.7	Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe ndarjes në burim	Bashkia Malësia Madhe; Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të,	2017-2018
		6.1.8	Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit	Bashkia Malësia Madhe; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm, Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të.	2018-2020

6.1.9	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët	Bashkia Malësia Madhe; Konsulentë &Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2017-2019
-------	--	---	-----------

9. RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e manaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri. Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonominë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

9.1. Monitorimi

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportojnë tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoriteteve përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritja e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilin do të maten ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

- 1) Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshtaten kontekstit real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
- 2) Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;
- 3) Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
- 4) Dokumentimi i konkluzioneve
- 5) Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit. Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtëm.

10. IMPAKTI I PROCESIT TË PLANIFIKIMIT

Aspektet e shërbimit të manaxhimit të mbejtjeve	Fund 2015	Objektivat e Planit	Fund 2016
Cilësia e shërbimit			
<i>Grumbullimi i mbejtjeve</i>	<ul style="list-style-type: none"> Në Bashkinë Malësia e Madhe shërbimi ofrohet në 4 njësi nga 6 gjithsej. Dy njësitë Gruemirë dhe Qendër nuk kishin shërbim. Secila njësi operonte me mjetin e saj dhe shërbimi i grumbullimit nuk ishte organizuar për të ekonomizuar koston. Mungonte standardizimi i shërbimit - mjetet e transportit nuk ishin të përshatshme për kontenerët (rastil Njësia Kastrat). Mjetet teknologjike të transportit të mbejtjeve ishin teje të amortizuar duke ulur cilësinë e ofrimit të shërbimit. Në disa njësi kontenerët ishin teje të amortizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> Mbulimi i të gjithë territorit të bashkisë Malësia Madhe me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbejtjeve. Përmirësimi i shërbimeve të pastrimit në të gjitha NJA ku ky shërbim ofrohet aktualisht: Ofrimi i shërbimeve të mbejtjeve efçiente dhe efikase; Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbejtjeve, marrëveshjeve dhe kontratave; Krijimi një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investimet e nevojshme); Mbyllja e fushës ekzistuese të depozitimit të mbejtjeve dhe gjetja e zgjidhjeve mjedisore dhe ekonomike në zbatim të politikës kombëtare dhe rajonale në depozitimin e mbejtjeve; Reduktimi depozitimeve ilegale të mbejtjeve urbane dhe sidomos të mbejtjeve voluminoze; Parandalimi i rrezikut nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbejtjeve të rrezikshme (si dhe mjeksore) në zbatim të legjislacionit shqiptar; Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe ndërkufitar për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij; Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për tu berë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të qytetit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbejtjeve; Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbejtjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshatshme pilot; Relaizimi i objektivave kombëtare për minizimin e mbejtjeve në nivel lokal. 	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë procesit të hartimit të planit bashkia u mundësua me analizat përkatëse në lidhje me nevojën për kontenerë dhe mjet teknologjik për të përmirësuar standardin e ofrimit të shërbimit. Bashkisë ju prezantuan 5 skenarë të mundshëm të ofrimit të shërbimit. Dy skenarët e parë propozonin ndarjen e bashkisë në tre zona dhe në dy zona shërbimi, ku u analizuan edhe koston përkatëse. Gjatë planifikimit bashkia u udhëzua për shtrirjen e shërbimit në zonat pa shërbim (shpërndarja e kontenerëve në magazinat e bashkisë në territor). Bashkia mori angazhim për blerjen e 100 kontenerëve të rinj dhe me anë të një bashkëfinancimi blerjen e një mjeti 10ton. Bashkia u mundësua me skenarët e lëvizjes së mjeteve në territorin e saj për të optimizuar kohen dhe përdorimin e makinave.
Qëndrueshmëria mjedisore			
<i>Grumbullimi i diferencuar</i>	<ul style="list-style-type: none"> Në bashki nuk kishte asnjë iniciativë për grumbullimin e diferencuar dhe bashkia nuk kishte një plan për zhvillimin e këtyre projekteve 		<ul style="list-style-type: none"> Gjatë procesit të planifikimit bashkisë i është propozuar plani për minimizim e mbejtjeve së bashku edhe me një plan ndërgjegjësimi për komunitetin.
<i>Trajtimi i mbejtjeve sipas legjislacionit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Mbejtjet në territorin e Bashkisë Malësia Madhe depozitoheshin në venddepozitimet e secilës njësi, jashtë kushteve higjieno sanitare. Mbejtjet grumbulloheshin nga kontenerët 1.1m3 dhe depozitohen direkt në këto fusha të hapura, ku në shumë raste janë pranë përrenjeve të lumenjve, si ajo e Koplikut 		<ul style="list-style-type: none"> Bashkia gjatë fazës së planifikimit ka kufizuar numrin e venddepozitimeve të mbejtjeve nga 4 në dy, ku praktikisht 5 njësi i dërgojnë mbejtjet në venddepozitimin e Koplikut (Koplik, Gruemirë, Kastrat, Shkrel, Qendër) dhe në atë të Kelmendit (kjo njësi është 38km larg nga Kopliku). Në 5 skenarët e prezantuar në plan për bashkinë janë prezantuar alternativa e ndërtimit të një stacioni transferimi, për eliminimin e vend depozitimeve aktuale dhe depozitimi i tyre në landfillin e Bushatit, shoqëruar me koston përkatëse.
<i>Mbrojtja e mjedisit në trajtimin dhe depozitimin e mbejtjeve</i>	<ul style="list-style-type: none"> Venddepozitimet e mbejtjeve janë toka të hapura pa asnjë lloj kriteri mbrojtës. I gjithë shllami i mbejtjeve depërton në shtresat nëntokësore. 		<ul style="list-style-type: none"> Gjatë fazës së planifikimit është hartuar një studim parafizibiliteti për mbylljen e venddepozitimit aktual në Kopluk dhe ndërtimin e një stacioni transferimi për të gjithë bashkinë.
Qëndrueshmëria financiare			
<i>Rekuperimi i koston</i>	<ul style="list-style-type: none"> Në dy njësitë që nuk ofrohej shërbim, nuk kishte buxhet të alokuar dhe as nuk aplikoheshin tariflat për mbejtjet. Në njësitë ku aplikoheshin, niveli i grumbullimit të tarifës ishte 11% e planifikimit (63% e familjeve kanë paguar dhe 24% e BV kanë paguara). 		<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë skenarët e propozuar për sistemin e manaxhimit të mbejtjeve janë shoqëruar me llogaritje koston dhe përcaktimi i tarifave në varësi të përqindjes të pagesës së tyre. Është zgjedhur që të llogariten tariflat në varësi të përqindjes të pagesës së tyre me qëllim që në të gjitha rastet të sigurohet mbulimi i koston nga tariflat.
<i>Eficienca e mbledhjes së tarifës</i>	<ul style="list-style-type: none"> E vetmja mënyrë e mbledhjes së tarifës është në zyrat e bashkisë. Në rast të mos pagesës qytetarët nuk mundësohen me shërbime administrative. 		

ANEKS I: PLAN I DETAJUAR PËR PROGRAMIN E NDËRGJEGJËSIMIT NË LIDHJE ME PROCESIN E MANAXHIMIT TË MBETJEVE DHE SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË TYRE

Objektivat e projektit dhe të programit të ndërgjegjësimit

Ky program, do t'iu vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të riciklimit dhe kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për të zhvilluar procesin e riciklimit dhe kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambjentet e shkollave.

Objektivat e fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese do të konsistojë si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjegjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbetjeve organike;
5. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e riciklimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për riciklimin e mbetjeve, si plastika, alumini, letra etj;
6. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet riciklimi dhe kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave;
7. Prezantimin e skemave të ndryshme të minimizimit të mbetjeve për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;
8. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve;
9. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e minimizimit të mbetjeve;
10. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata ndërgjegjësuese dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të njësive vendore dhe do të jenë ato, të cilat do të zbatojnë këtë program në territorin e njësive të tyre. Konkretisht me anë të këtij programi stafet lokale të njësive do të synojnë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifikisht për nxënësit e shkollave. Njësitë vendore duhet të sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program.

Në lidhje me burimet financiare njësitë vendore duhet të parashikojnë si fillim në buxhetet e tyre një zë të veçantë për programin e ndërgjesimit dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:

1. Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushateve ndërgjegjëse, si broshura, postera apo stenda për në ambientet e njësive vendore dhe shkollave
2. Përgatitja e spotit publicitar informues për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik
3. Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të njësive lokale dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale
4. Përfshirja e ekspertëve/ trajnuesve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkolla dhe në komunitet
5. Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin

Si fillim përfaqësuesit e njësive vendore do të jenë pjesë e ëorkshopeve që do të zhvillohen në kuadër të projektit, ku do të njihen fillimisht me skemën e re të manaxhimit të mbetjeve dhe skema specifike e riciklimit apo kompostimit të mbetjeve, mundësitë që ka zona për të zhvilluar këto skema, grupet e interesit që realisht kanë mundësi dhe interes, përfitimet ekonomike të tregut nga aplikimi i skemës, vendosja e sistemit të tarifave për të përfituar shërbime më të mira mjedisore si dhe paraqitja e një plani informues dhe ndërgjegjëses për komunitetin.

Programi i fushatës ndërgjegjëse dhe informuese për manaxhimin e mbetjeve

Rritja e njohurive të komunitetit dhe nxënësve në lidhje me skemat ndërvendore të manaxhimit të mbetjeve



HAPI 1- VEPRIMTARITË PARAPRAKE TË NDËRGJEGJËSIMIT

Njësia vendore duhet të promovojnë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve (në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuar për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë njerëzit se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në krahasim me

mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikat aktuale të manaxhimit të mbetjeve. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkese (me anë të një pyetësi, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve).

Nisur nga ky fakt, njësitë vendore mund të fillojnë fushatën e ndërgjegjësimit me anë të **një pyetësi**, i cili mund të përsëritet periodikisht (**1-2 herë në vit**), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave të reja të manaxhimit të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në **lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt tarifës së mbetjeve**, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të ndërgjegjësimit publik, të cilat mund të përdoren nga njësitë vendore si fazë fillestare e ndërgjegjësimit të komunitetit për manaxhimin e mbetjeve është **metoda derë më derë** duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.



HAPI 2- RITJA E INTERESIT

Një një fazë të dytë, komuniteti që tashmë është informuar dhe ndërgjegjësuar për çështjet e manaxhimit të mbetjeve, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shtesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shtesë, përderisa njësi do të vendosë që të zbatojë këto skema të manaxhimit të mbetjeve në territorin që ata administrojnë.

Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. **për praktikën e kompostimit dhe riciklimit të mbetjeve ose për praktikën e ndarjes së mbetjeve**. Kryesisht në zonën e përzgjedhur do të zbatohen skemat e kompostimit të mbetjeve në nivel komuniteti dhe shkollash⁶, dhe ato të riciklimit në nivel biznesesh. Gjatë kësaj faze duhet që njësitë vendore të fillojnë të hartojnë një program të detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për manaxhimin e mbetjeve, por edhe konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë njësi vendore për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në

⁶ Në pjesën më poshtë ka informacion të zgjeruar në lidhje me programe konkrete ndërgjegjësimi dhe informimi për kompostimin në nivel komuniteti dhe shkollash.

terren, në impiantet e mbetjeve apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe manaxherë të mbetjeve.



HAPI 3- VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Në këtë fazë, drejtuesit e programeve, që janë përfaqësuesit e njësive vendore, duhet të jenë në gjëndje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij të për një periudhë **çdo 3 mujore**, për të parë nëse programi është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat. Falë vlerësimit mund të përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj. Nga ana tjetër, autoritetet vendore synojnë të përfshijnë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku njësia vendore përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

1. **Vlerësim vizual** në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve;
2. **Vlerësim sasior**, në lidhje me sasinë e mbetjeve të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbetjeve (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
3. **Vlerësim cilësor** i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtmin e mbetjeve, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbetjeve, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
4. **Vlerësim i opinionit të qytetarëve**, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve me anë të një pyetësori të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah: i) **A është e përshatshme skema për qytetarët;** ii) **A janë ata të ndërgjegjësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës;** iii) **Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të manaxhimit të mbetjeve etj.**

Gjatë kësaj faze, si autoritetet ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarët për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

Informimi për Sistemin e ri të tarifave

Njësitë vendore me fillimin e aplikimit të skemave të reja ndërvendore, do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbetjeve, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Nisur nga ky fakt, njësitë vendore do të duhet të fillojnë një fushatë ndërgjegjësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do tu duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë.

Në fushatën ndërgjegjësuere për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re ndërvendore, njësitë vendore duhet të marrin në konsideratë këto parime:

- 1. Alokimin efiçient të burimeve që ka në dispozicion njësia vendore**
- 2. Ofrimi në mënyrë sa më efiçiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët**
- 3. Përdorimi efiçient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit**
- 4. Mbulimi i kostos – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve**
- 5. Qëndrueshmëria financiare – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë një qëndrueshmëri të sistemit të manaxhimit të mbetjeve**
- 6. Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar**
- 7. Zbatimi i parimit “Ndotësi Pague”**
- 8. Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar**
- 9. Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për publikun**

Procesi i vendosjes së tarifës së mbetjeve duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjësuere për tarifat e mbetjeve:

- 1. Njohja me konsumatorët** – njësia vendore duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbetje në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.

2. **Sasia e mbetjeve që gjenerohen në njësinë vendore** – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, njësia vendore duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbetjeve për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbetjeve që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar këtë shërbim.
3. **Vlerësimi i opsioneve teknike** – Skema e re ndërvendore do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenierëve, lloji i tyre për mbetjet miks apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitimin e mbetjeve etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. **Vendosja e marrëdhënies institucionale** – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësisve dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të manxhimit të mbetjeve? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikat përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. **Njohja me koston e ofrimit të shërbimit** – Për të vendosur tarifa sa më realiste duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të manxhimit të mbetjeve sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve; iv) trajtimin final të mbetjeve; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.
6. **Identifikimi i burimit të të ardhurave** – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.
7. **Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifat dhe llogaritja e tyre** – Pasi njësia vendore ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kosot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.
8. **Vendim-marrja strategjike** – Në sajë të karakteristikave të njësive vendore merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e koston pritët që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.
9. **Komunikimi i sistemit të ri të tarifave** – Njësitë vendore mund të përcaktojnë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, **të cilat mund të realizohen me anë të ëorkshopeve periodike, stendave në hyrje të njësive vendore apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart.**

Kompostimi i mbetjeve

a) Promovimi i kompostimit të mbetjeve në nivel komuniteti

Në njësitë vendore do të aplikohen skema kompostimi, si fillim për të informuar qytetarët në lidhje me këtë iniciativë të re. Për aplikimin e skemave të kompostimit propozohet që njësitë vendore të hartojnë një program, ku për një periudhë **3-4 muajore**, dy herë në vit (kryesisht në periudhën e pranverës dhe fundin e verës ku koha është më e thatë dhe më lehtë për të filluar këtë proces), çdo **2-3 javë** të realizohet një fushatë ndërgjegjësimit me titull **“Java lokale e ndërgjegjësimit për kompostimin e mbetjeve në zonën e Pukës”**


Në kuadër të kësaj jave, njësitë vendore mund të përgatisin një leaflets (flyer) informues për ta shpërdarë në komunitetin e gjërë, i cili mund të përmbajë informacionin si më poshtë:

- i) Njoftim për ëorkshop falas për kompostimin për komunitetin në ambjentet e përzgjedhura nga njësitë vendore: çfarë është ai, si mund të kryhet, kushtet e përshtatshme për realizimin e tij, llojet e vermi kompostit që duhet të përdoren. Duke qënë që fushata do të përsëritet për disa javë gjatë një periudhe 4 muajore, këto ëorkshope mund të realizohen në zona me komunitete të ndryshme për të mbuluar sa më shumë territorin me informacion;
- ii) Gjatë zhvillimit të ëorkshopeve mund të zhvillohet një sesion i veçantë në lidhje me aplikimin e instrumentave nxitës financiarë për stimulimin e kompostit të mbetjeve (p.sh. komposti i prodhuar do të blihet nga kompanitë e interesuara ose nga vetë bashkia për përdorimet e saja) etj;
- iii) Njoftim për ofrimin e vermi kompostit në tregun e fermerëve me një çmim të arsyeshëm, gjatë ditës që do të zhvillohet ëorkshop-i. Nëse nuk ka një treg fermerësh mund të improvisohet nga ana e njësisë vendore një aktivitet, në sheshin kryesor të qytetit apo komunës, ku komuniteti mund të blejë vermi kompost të llojeve të ndryshme më një çmim të arsyeshëm. Të ardhurat e gjeneruara nga këto blerje, njësitë mund t'i përdorë për të blerë kontenerë kompostimi për shkollat e qytetit që duan të zhvillojnë aktivitet kompostimi, si dhe për sigurimin e bazës së parë materiale për fillimin e kompostimit të mbetjeve organike;
- iv) Sipas periudhës kur do të zhvillohet java e ndërgjegjësimit, në ditët mjedisore si **22 Prill (dita e tokës), 5 Qershor (dita botërore e mjedisit), 24 Nëntor (Dita botërore e mbjelljes së pemëve)** të organizohen ëorkshopet e mësipërme, apo tregu në sheshin e qytetit për blerjen e vermi kompostit, ose në leaflet informues mund të njoftohet se një nga shkollat “sot” të organizojë një demonstrim konkret të kompostimit të mbetjeve në oborrin e shkollës;
- v) Gjatë zhvillimit të fushatës ndërgjegjësuese përgjatë 1 jave, njësitë vendore me anë të një grupi studentësh vullnetarë mund të realizojë një pyetësor për komunitetin për të vlerësuar njohuritë aktuale dhe gadishmërinë që kanë qytetarët në zhvillimin e kompostimit të mbetjeve organike në nivel komuniteti;
- vi) Në leaflets informues, njësitë vendore mund të vendosë një numër telefoni, ku qytetarët mund të telefonojnë për të marrë informacion më të shpejtë në lidhje me kompostimin, procesin si zhvillohet, aktorët që mund të përfshihen etj. Ky mund të quhet si **“Telefoni i mbetjeve” ose “Numri i gjelbërt për mbetjet”**;
- vii) Në ambjentet e njësisë vendore apo edhe në institucionet shtetërore ku do të aplikohen skemat e kompostimit mund të vendoset një kuti e Ankesave/ Sugjerimeve për qytetarët;
- viii) Në stendën kryesore të njësisë vendore në fillim të çdo javë ndërgjegjësimit mund të vendoset informacioni në lidhje me aktivitet që do të zhvillohen gjatë gjithë javës, ku mund të përfshihen edhe hartat, të cilat tregojnë më qartë vendodhjen e aktiviteteve etj.

Përgjegjësitë

Përgjegjësia për zhvillimin e fushatës do të jetë e punonjësive të bashkisë si dhe e grupeve të interesit, të cilët paraprakisht duhet të kenë nënshkruar një marrëveshje me njësitë vendore në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë bashkëpunim.

Afatet kohore të zhvillimit të fushatës



★ **Java lokale e ndërgjegjësimit për kompostimin e mbetjeve në zonën e Pukës** – Sipas parashikimit ajo do të zhvillohet çdo 3 javë për gjatë një periudhe 3 mujore, dy here në vit

b) Promovimi i kompostimit të mbetjeve në shkolla

HAPI 1

Të gjitha shkollat, të cilat do të duan të fillojnë të zbatojnë një program për kompostimin e mbetjeve duhet të **hartojnë një program fillestar njoftimi për këtë iniciativë**, i cili duhet të konsistojë në:

- i) Shpërndarjen e idesë për kompostimin e mbetjeve dhe kërkimin për aktorë, të cilët janë të interesuar të jenë pjesë e kësaj iniciative;
- ii) Rekrutimi i një grup të vogël për të zhvilluar idenë dhe themelimin e Komitetit të Drejtimit të procesit për kompostimin e mbetjeve organike;
- iii) Kërkime fillestare në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për zhvillimin e procesit të kompostimit në shkollë;
- iv) Përcaktimi qartë i objektivave të projektit.

HAPI 2

Hartimin e një udhëzuesi për nxënësit e shkollave që duan të zhvillojnë kompostimin e mbetjeve organike në ambjentet e tyre. Ky udhëzues mund të bëhet pjesë e lëndëve mësimore, ku **nxënësit 1 herë në javë** mund të kenë dy orë mësimore. Në javët e para (gjatë muajit të parë) do të marrin mësim në lidhje me procesin e kompostimit, si kryhet, cilat janë karakteristikat, kushtet në të cilat do të kryhet etj. Ndërkohë në javët në vazhdim gjatë dy orëve mësimore ata do të zhvillojnë konkretisht kompostimin e mbetjeve organike në oborrin e shkollës dhe çdo javë do të kujdesen për kompostin deri sa ai të bëhet gati. **Kurrikulat e lëndës mësimore për kompostimin e mbetjeve mund të përmbajë konceptet më poshtë:**

- i) **Përshkrimi i përfitimeve të aplikimit të këtyre skemave në shkolla:** Aplikimi i skemave të kompostimit në shkolla mund të sjellë një sërë përfitimesh: i) Komposti si një produkt final mund të përmirësojë cilësinë e tokës dhe të bimëve të mbjellta në shkolla apo në parqet e qytetit; ii) Promovimi i mundësive të edukimit për praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm; iii) Reduktimin e koston të transportit të mbetjeve në shkolla

- ii) **Përse duhet të kompostojmë dhe përfitimet që kemi nga kompostimi** – Nxënësit kanë nevojë të dinë nëse procesi që ata do të zhvillojnë do të sjellë njohuri të reja për ta, do të sjellë përfitime për shkollën dhe për komunitetin. Në thelb ata duhet të ndërgjegjësohen me konceptin e kompostimit të mbetjeve organike, si një proces i cili do të kontribuojë në manaxhimin e integruar të mbetjeve në njësinë e tyre vendore, dhe si rezultat reduktimin e mbetjeve për trajtim final dhe uljen e kostos së transportit, duke sjellë përfitime ekonomike dhe përmirësimin e shërbimit të mbetjeve
- iii) **Propozimi i një skeme të thjeshtë për kompostimin e mbetjeve në shkollë:** i) llojet e mbetjeve që do të kompostohen; ii) procesi që duhet të zhvillojnë nxënësit; iii) Fazat gjatë të cilave do të zhvillohet komposti; iv) Çfarë do të ndodhë me kompostin e krijuar, si do të veprojnë nxënësit, ku do ta dërgojnë, kush do të përfitojë etj.

HAPI 3

Kjo skemë ka nevojë edhe për hartimin e **një rregullore të brendshme**, ku **përcaktohen qartë rolet e aktorëve që do të përfshihen në skemën e kompostimit të mbetjeve në shkollë**, puna që do të kryejnë studentët etj. Kjo rregullore duhet të shoqërohet edhe me një **manual për rregullat e higjenes dhe shëndetit** që duhet të kenë parasysh drejtuesit e shkollave dhe nxënësit gjatë zbatimit të skemës së kompostimit.

HAPI 4

Planifikimi i detajeve të tjera të fushatës ndërgjegjësuese në shkollë:

- i) **Në ambjentet e shkollës** mund të vendosen **postera promovues**, të cilët promovojnë fillimin e kësaj iniciative, shpjegojnë procesin e kompostimit që do të zhvillojnë nxënësit në shkollë (nëse në ambjentet e shkollës ka një zonë ushqimi është mirë që ato të vendosen edhe në këto ambjente posterat shpjegues). Punonjësit e zonës së ushqimit duhet të jenë të informuar në lidhje me ndarjen e mbetjeve ushqimore që do të shkojnë për kompostim;
- ii) **Ideimi i konkurseve të vogla**, ku nxënësit që ndajnë ashtu siç duhet mbetjet për kompost vlerësohen nga shkolla/promovohen për të udhëhequr procesin për një afat të caktuar deri në zhvillimin e konkursit tjetër;
- iii) Vetë nxënësit në bashkëpunim me stafin pedagogjik që ndjek procesin e kompostimit mund të ndërtojnë **një stendë, ku të paraqesin çdo javë rezultatet në lidhje me sasinë e mbetjeve** që gjenerojnë dhe sasinë e mbetjeve që kompostojnë;
- iv) Në kontenierët që do të hidhet komposti duhet të vendosen **letra që specifikojnë se çfarë konkretisht do të kompostohet**;
- v) **Hartimi i një plani trajnimi për nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit**, të cilët janë të interesuar të kontribuojnë në këtë proces, i cili mund të shtrihet gjatë gjithë vitit i ndarë në dy pjesë: Gjatë semestrit të parë zhvillimi i seancave të trajnimit për nxënësit 1 herë në 2 javë dhe gjatë semestrit të dytë angazhimi i nxënësve që 1 herë në muaj të zhvillojnë ditë të veçanta në qytet për promovimin e kompostimit;
- vi) **1 herë në muaj mund të zhvillohen vizita në terren nga nxënësit e shkollave pranë fermave të mëdha**, ku ata mund të kërkojnë që fermerët të sjellin një pjesë të lëndës së

tyre organike për ta kompostuar në ambjentet e shkollave. Gjithashtu nëse në këto ferma kryhet procesi i kompostimit, nxënësit mund të mësojnë më shumë dhe t'i zbatojnë në stendën e tyre të kompostimit në shkollë.

